

**KODI I QEVERISJES KORPORATIVE I
HALKBANK AD SKOPJE**

shtator 2018

PARATHËNIE

Në pajtim me „Vendimin mbi parimet dhe principet e qeverisjes korporative në bankë“, e miratuar nga Banka popullore e Republikës së Maqedonisë (Gz. zyrtare e RM-së nr.159/2007), Vendimin për rregullat e qeverisjes së mirë korporative në bankë (Gz. zyrtare e RM-së nr.24/18), Kodi për qeverisje korporative (“Kodi”) i Halkbank AD Skopje (“Banka”) është përgatitur nga ana e Këshillit mbikqyrës së Halkbank AD Skopje, ndërsa i miratuar nga ana e Kuvendit të aksionarëve të Bankës. Kodi është rishikuar, ndryshuar dhe plotësuar nga ana e Kuvendit të aksionarëve të Bankës në datë 09.05.2011, 27.04.2012 dhe 27.06.2016. Për shkak të ndryshimeve të ndodhura në rregullativet, ndryshimet dhe plotësimet janë bërë nga ana e Këshillit mbikqyrës në mbledhjen e mbajtur më 20.09.2018 si organ përgjegjës për miratimin e Kodit.

Kodi është miratuar në pajtim me Vendimin e përmendur të BPRM-së si dhe akteve me të cilët rregullohet qeverisja korporative.

Ky Kod i përmban rregullat për qeverisje korporative dhe rregullat për mbikqyrjen e qeverisjes në Halkbank AD Skopje.

Qeverisja korporative paraqet përmbledhje të raporteve të ndërsjella ndërmjet aksionarëve të Bankës, Këshillit mbikqyrës, Këshillit drejtues, personave të tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe personave të tjerë të interesuar, përmes së cilave vendosen struktura adekuate organizative dhe mekanizmat adekuat për definimin e objektivave të Bankës dhe për realizimin dhe monitorimin e tyre. Kjo nënkupton definimin e të drejtave dhe përgjegjësi të këtyre personave, në veçanti atyre si Këshilli mbikqyrës dhe drejtues:

- e definojnë politikën afariste të Bankës;
- kryejnë mbikqyrje të punës së Bankës, respektivisht menaxhojnë me punën e përditshme të Bankës;
- i mbrojnë interesat e deponentëve, i përmbushin detyrimet ndaj aksionarëve dhe i kanë parasysh interesat e personave të tjerë të interesuar;
- krijojnë kulturë dhe vlera korporative;
- bëjnë zgjedhjen e të punësuarëve dhe e përcjellin punën e tyre;
- i vendosin funksionet e kontrollit të Bankës.

Nën termin „kulturë dhe vlera korporative“ nënkuptohen rregulla dhe standarde me të cilat mundësohet veprim i përgjegjshëm dhe etik në procesin e komunikimit me personat e interesuar, gjatë shpërndarjes së resurseve për arsye të përmbushjes së politikës afariste të bankës, në zhvillimin e resurseve njerëzore dhe në procesin e marrjes së vendimeve gjatë punës së përditshme të Bankës.

Nën personat e interesuar, nënkuptohen deponentët, aksionarët, kreditorët e tjerë të bankës, investitorët, organet rregulluese dhe mbikqyrëse, institucionet e jashtme për rejting kreditor, Fondi për sigurimin e depozitave, shoqëritë e revizionit dhe subjekte të tjera që kanë interes për punën e Bankës.

Qëllimi i Kodit është vendosja e sistemit të qeverisjes dhe kontrollit të Bankës, i cili është përpiluar dhe drejtuar që të krijojë vlerë të qëndrueshme dhe afatgjate të Bankës. Dedikimi i Kodit është që ti përmbush nevojat e të gjitha personave të interesuar, mirëqenia e të cilëve varet nga sukcesi i Bankës. Kodi është miratuar në drejtim të rritjes së shkallës së transparencës për të gjitha palët e interesuara.

PËRMBAJTJA E KODIT

1. PARIMET E QEVERISJES SË MIRË KORPORATIVE	4
2. PROCEDURA PËR THIRRJEN E KUVENDIT, PROCEDURA E VOTIMIT, TË DREJTAT E AKSIONARËVE PËRFSHIRË EDHE TË DREJTËN E AKSIONARËVE PAKICË	7
3. BASHKËPUNIMI NDËRMJET KËSHILLIT MBIKQYRËS DHE DREJTUES, LLOJI, AFATET DHE MËNYRAT SE SI KËSHILLI DREJTUES DORËZON INFORMACIONE DHE DOKUMENTE DERI TE KËSHILLI MBIKQYRËS DHE MËNYRA E VEPRIMIT NË SITUATA KUR EKZISTON KONFLIK INTERESI	11
4. OBLIGIMET DHE PËRGJEGJËSITË E KËSHILLIT MBIKQYRËS, KËSHILLIT DREJTUES DHE ORGANEVE TË TJERA DHE MËNYRA E PUNËS SË TYRE	13
5. KRITERET DHE RREGULLAT PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKQYRËS DHE MËNYRA E SHPËRBLIMIT TË TYRE	21
6. KRITERET DHE RREGULLAT PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES DHE SHPËRBLIMIN E TYRE, EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT PËR REVIZION, ANËTARËVE PËR MENAXHIMIN ME RREZIQE DHE ORGANEVE TË TJERA TË BANKËS	23
7. ROLI, KUPTIMI DHE FUSHËVEPRIMI I PUNËS SË FUNKSIONEVE TË KONTROLLIT	28
8. PERSONA TË TJERË ME TË DREJTA DHE PËRGJEGJËSI TË VEÇANTA	33
Persona të tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, për nevojat e kësaj pike, janë personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të përcaktuara me Statutin e Bankës, me përjashtim të anëtarëve të Këshillit mbikqyrës, Këshillit drejtues, Këshillit për revizion dhe Këshillit për menaxhim me rreziqe.	33
9. STRUKTURA E HALK BANKASI A.SH	34
10. KODI ETIK, POLITIKA E SHMANGIES SË KONFLIKTIT TË INTERESIT, POLITIKA E SHPËRBLIMIT DHE RREGULLORJA PËR RAPORTIM TË BRENDSHËM TË MBROJTUR	34
11. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE.....	35

1. PARIMET E QEVERISJES SË MIRË KORPORATIVE

- **Anëtarët e Këshillit mbikqyrës disponojnë me kualifikime përkatëse, e kuptojnë rolin e tyre në qeverisjen korporative të Bankës dhe janë të aftë për vlerësim real të punës së Bankës**

Sipas këtij parimi janë definuar kualifikime përkatëse të cilat duhet ti plotësojë anëtari i Këshillit mbikqyrës. Në pajtim me këtë parim, anëtari i Këshillit mbikqyrës periodikisht kryen vlerësim të efikasitetit të punës së tij, i identifikon dobësitë e punës së Këshillit mbikqyrës dhe propozon ndryshime, mban takime të rregullta me Këshillin drejtues, Këshillin për menaxhim me rreziqe, Këshillin për revizion dhe Drejtorinë për revizion të brendshëm të Bankës. Anëtari i Këshillit mbikqyrës jep propozime për qeverisje të mirë korporative të Bankës dhe në mënyrë efikase e kryen rolin e tij të mbikqyrjes në Bankë, shfaq besnikëri dhe kujdes për Bankën dhe shmang konflikt interesi ose konflikt të mundshëm të interesit. Këshilli mbikqyrës nuk merr pjesë në qeverisjen e përditshme me Bankën.

- **Organet e drejtimit dhe mbikqyrjes së Bankës i përcaktojnë dhe e ndjekin përmbushjen e objektivave strategjike dhe vlerave korporative të Bankës dhe për to i njoftojnë të gjithë të punësuarit e tyre**

Element i rëndësishëm në qeverisjen korporative të Bankës është miratimi i strategjisë fatagjate të Bankës, rivlerësimi i vazhdueshëm i përmbushjes së saj dhe përmirësimi i punës në drejtim të realizimit të qëllimeve të definuara në strategji.

Këshilli mbikqyrës dhe drejtues i Bankës përcaktojnë Indikatorë për përmbushjen e strategjisë, në bazë vjetore, kurse aktet e përgjithshme të Bankës i përcaktojnë indikatorët kuantitativë dhe kualitativë në realizimin e qëllimeve të strategjisë. Sipas këtij principi Këshilli drejtues përgadit Kodin etik të Bankës, dhe në bazë të së njejtës përgadit politika dhe procedura me të cilat identifikohen konfliktet potenciale të interesit dhe definohen aktivitetet që do të ndërmerren në rast të egzistimit të konfliktit të interesit. Këshilli mbikqyrës e aprovon Kodin etik të Bankës dhe politikat e egzistimit të konfliktit të interesit. Poashtu, Këshilli mbikqyrës dhe drejtues vendosin politika dhe procedura, në bazë të së cilave do të mundësohet komunikim i pandërprerë dhe mundësi për informim nga ana e cilit do të punësuar në Bankë për rastet e korrupsionit, sjelljeve dhe aktiviteteve të tjera joligjore dhe joetike. Në kontekst të kësaj, Drejtoria për revizion të brendshëm kryen revizion të rregullt sa i përket zbatimit të standardeve profesionale dhe vlerave korporative.

- **Organet e mbikqyrjes dhe qeverisjes vendosin përgjegjësi të definuara përkatëse dhe linja të informimit ndërmjet të punësuarve në Bankë**

Sipas këtij principi organet e mbikqyrjes dhe qeverisjes së Bankës në pajtim me opusin dhe llojin e aktiviteteve të tyre, sigurojnë procedurë të qartë, transparente dhe të dokumentuar të vendimmarrjes dhe ndarje të qartë dhe konzistente të drejtave dhe përgjegjësi. Këshilli mbikqyrës dhe drejtues i Bankës bashkëpunojnë në bazë të dokumentuar dhe të përhershme, me të drejta dhe përgjegjësi të definuara në detaje për Këshillin mbikqyrës, Këshillin drejtues, si dhe bashkëpunimin ndërmjet këtyre dy organeve, me të cilën mundësohet zbatim i suksesshëm i sistemit të qeverisjes korporative, të definuar në këtë Kod.

- **Këshilli mbikqyrës i Bankës duhet të jetë i sigurt se Këshilli drejtues dhe personat e tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta kryejnë mbikqyrje përkatëse dhe monitorim të punës së Bankës**

Sipas këtij principi Këshilli drejtues i përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e personave të tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të cilët kryejnë funksione drejtuese në Bankë dhe në mënyrë të vazhdueshme e mbikqyrin përmbushjen e tyre, miraton dhe zbaton politika për mënyrën e zgjedhjes, përcjelljen e punës dhe shkarkimin e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, kryen vlerësim mbi përshtatshmërinë e personave të tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, përveç për anëtarët e Këshillit mbikqyrës, Këshillit për menaxhim me rreziqe, Këshillit për revizion dhe Këshillit drejtues.

- **Këshilli mbikqyrës, Këshilli drejtues dhe personat e tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta që kryejnë funksione drejtuese në Bankë, duhet t'a shfrytëzojnë në mënyrë efektive punën e Drejtorisë për revizion të brendshëm si dhe punën e shoqatës për revizion**

Sipas këtij principi organet e qeverisjes dhe mbikqyrjes së Bankës dhe personat e tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, kontribuojnë në rritjen e efikasitetit të revizionit të brendshëm të Bankës, nëpërmjet sigurimit të pavarësisë së plotë të Drejtorisë për revizion të brendshëm, objektivitetit dhe neutralitetit në zbatimin e revizionit të brendshëm, sigurimin e kushteve për qasje deri te të gjithë dokumentet dhe informacionet e nevojshme, pranimin efikas dhe në kohë të konkludimeve dhe zbatimin e rekomandimeve të revizionit të brendshëm, angazhimit të revizionit të brendshëm për vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit me rreziqet.

Këshilli drejtues dhe mbikqyrës i Bankës janë të obliguar të sigurojnë efikasitet të Drejtorisë për revizion të brendshëm përmes qasjes së plotë të punësuarve në Drejtorinë për revizion të brendshëm, deri te të gjitha dokumentet, informacionet, pronat dhe procesverbalet e të gjitha organeve të Bankës, si dhe mundësinë për komunikim të drejtpërdrejtë me cilindo të punësuar në Bankë, pranimin me kohë dhe zbatimin e rekomandimeve të revizionit të brendshëm, zbatimin e standardeve profesionale nacionale dhe ndërkombëtare për revizion të brendshëm si dhe njoftimin e plotë dhe me kohë të Drejtorisë për ndodhitë më të rëndësishme në Bankë, për futjen në treg të produkteve të reja, aktiviteteve dhe sistemeve dhe ndryshimeve të tjera.

Nga aspekti i kapacitetit njerëzor, profilit arsimor dhe objektivitetit të punësuarve në Drejtorinë për revizion të brendshëm, Këshillin mbikqyrës dhe drejtues janë të obliguar të angazhojnë resurse njerëzore në Drejtori të cilët bashkarisht posedojnë njohuri dhe përvojë adekuate për aktivitetet që zhvillon Banka dhe rreziqet në të cilat është e ekspozuar, trajnim me kohë dhe adekuat të punësuarve në Drejtori dhe objektivitet dhe paanshmëri në zbatimin e revizionit të brendshëm, përmes përjashtimit të mundësisë për angazhimin e të punësuarve në Drejtori në zbatimin e aktiviteteve të tjera në Bankë.

- **Këshilli mbikqyrës dhe drejtues duhen të jenë të sigurt se Politika për shpërblim dhe procedura përkatëse është në pajtim me kulturën korporative, objektivat dhe strategjitë afatgjate, si dhe me rrethinën kontrolluese të Bankës**

Në pajtim me këtë princip Këshilli mbikqyrës i Bankës sjell Politika për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit drejtues, personave të tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta që kryejnë funksione drejtuese dhe të punësuarit në Bankë, e cila definojnë rregulla dhe kritere. Kuvendi i bankës është përgjegjës për aprovimin e Politikës së shpërblimit, nëse ajo parashikon marrjen e kompenzimit në formë të aksioneve ose të drejtave të tjera që japin mundësi për përvetësimin e aksioneve.

Vendimin për shpërblim e sjell Këshilli mbikqyrës.

Të dhënat e politikës së shpërblimit të Këshillit drejtues janë të përfshira në Raportin vjetor mbi punën e Bankës.

Politika e shpërblimit duhet të jetë në përputhje me politikën afariste të Bankës, planin financiar dhe objektivat afatgjata të bankës, të mos i nxit të punësuarit ose anëtarët e organeve të tjera të Bankës të ndërmarrin nivel më të lart të rrezikut nga ai nivel i përcaktuar dhe të përmbajë mekanizma për shmangien e konfliktit të interesit.

Informacionet dhe të dhënat në Raportin për qeverisje korporative lidhur me zbatimin e politikës së shpërblimit në Bankë kanë të bëjnë të paktën me:

- kriteret kryesore për shpërblim;
- raportin e pjesës fikse dhe variabile të kompenzimit të përgjithshëm;
- kriteret mbi të cilët është përcaktuar pjesa e kompenzimit që arkëtohet në formë të aksioneve ose të drejtave të tjera që japin mundësi për përvetësimin e aksioneve;
- shumën e kompenzimit të përgjithshëm të arkëtuar gjatë vitit sipas grupeve të ndara (p.sh. anëtarë të Këshillit mbikqyrës, anëtarë të Këshillit drejtues, peronat e tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, të punësuarit e tjerë në bankë dhe të ngjashëm), me çrast në mënyrë të ndarë tregohet pjesa fikse dhe variabile e kompenzimit të arkëtuar dhe numri i personave në çdo grup;
- strukturën e kompenzimit të përgjithshëm sipas shumës dhe numrit të personave që ju është arkëtuar shuma adekuate gjatë vitit nga kompenzimi i përgjithshëm;
- të dhënat e tjera në pajtim me Ligjin.

- **Sigurimi i transparencës së qeverisjes korporative në Bankë**

Në pajtim me këtë princip, Banka është e obliguar të publikojë të dhëna dhe informacione në lidhje me qeverisjen e saj korporative, të cilat duhet të jenë të sakta, relevante, në kohë dhe të disponueshme për të gjithë subjektet që kanë nevojë për to.

Banka është e obliguar që një herë në vit të përpilojë raport mbi qeverisjen korporative, i cili është pjesë përbërëse e raportit vjetor për veprimtarinë e bankës.

Raporti mbi udhëheqjen korporative përmban:

- informacione dhe të dhëna për përbërjen dhe funksionimin e Këshillit mbikqyrës dhe Këshillit drejtues dhe organeve tjera të bankës (informacione mbi numrin dhe përbërjen e organeve të bankës, procedura mbi emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve, kualifikimet e tyre, kriteret mbi pavarësinë e anëtarit të Këshillit mbikqyrës dhe të Këshillit për revizion, definimi i interesit material dhe sjellja afariste me bankën, obligimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Këshillit mbikqyrës të bankës etj.);
- informacione dhe të dhëna mbi strukturën organizative të bankës, përfshirë edhe degët e saj;
- strukturën aksionare të bankës – emërtimi i aksionarëve me pjesëmarrje kualifikuese dhe pjesëmarrja e tyre në numrin e përgjithshëm të aksioneve me të drejtë vote dhe numri i përgjithshëm i aksioneve të lëshuara me të drejtë vote dhe përfaqësuesit e tyre në Këshillin mbikqyrës të Bankës;
- informacione dhe të dhëna lidhur me zbatimin e Politikës së shpërblimit në Bankë;

- informacione dhe të dhëna që janë të lidhura me zbatimin e Kodit, si dhe shpjegimi i përputhshmërisë, respektivisht arsyet për mospërputhshmërinë e udhëheqjes korporative të bankës me dispozita dhe parime të caktuara nga Kodi që zbatohet në Bankë;
- informacione dhe të dhëna mbi politikën e bankës për parandalimin e konfliktit të interesit.
- informacione për shfrytëzimin e shërbimeve nga persona të jashtëm të cilët janë të rëndësishëm për punën e tërësishme të Bankës.

Në rast të ndryshimeve të rëndësishme lidhur me informacionet dhe të dhënat e lartpërmendura dhe të cilat ndodhin pas publikimit të Raportit të fundit të qeverisjes korporative, në afat prej 15 ditëve nga ndryshimi i ndodhur, njoftohet Banka popullore e Republikës së Maqedonisë.

- **Këshilli mbikqyrës dhe Këshilli drejtues i Bankës e njohin strukturën operative të saj, përfshirë edhe rastet kur Banka punon në shtete të tjera ose nëpërmjet strukturave të tjera të cilët e ulin transparencën (parimi “njihe strukturën tënde”).**

Sipas këtij principi nëse Banka vepron në shtete të tjera ose nëpërmjet strukturave tjera që e ulin transparencën e saj, Këshilli mbikqyrës dhe Këshilli drejtues i Bankës vendosin politika dhe procedura të veçanta, nëpërmjet të cilave rregullisht vlerësohet nevoja për veprim nga ana e Bankës në shtetet tjera, udhëhiqet me të gjithë rreziqet e mundshme (përfshirë edhe rrezikun juridik dhe atë mbi reputacionin), definohet procedura për miratimin e transaksioneve ose produkteve të reja, përcillet përputhshmëria e aktiviteteve të bankave të këtyre shteteve me ligjet, rregullativat, aktet interne dhe politikat e Bankës dhe sigurohet kontrolli i tyre nga ana e revizionit të brendshëm dhe të jashtëm.

➤ MODELI AFARIST I HALKBANK AD SKOPJE

Veprimtaria kryesore e Bankës paraqet mbledhjen e depozitave të popullsisë dhe ndërmarrjeve dhe dhënien e kredive popullsisë dhe ndërmarrjeve si dhe realizimin e qarkullimit pagesor në vend dhe jashtë vendit.

Modeli afarist i Bankës është rreptësisht i fokusuar në ndërtimin, diversifikimin dhe stabilizimin e bazës së saj të depozitave. Si Bankë komerciale, Banka qëndron relativisht afër modelit tradicional të afarizmit bankar. Në të gjitha aspektet e Bankës investohet në profesionalizmin dhe fokusimin e të punësuarve kah klientët. Me qëllim të qëndrueshmërisë së ambicieve të saj për rritje afatgjate, Banka zbaton kombinim të qeverisjes së kujdesshme të kapitalit dhe likuiditetit dhe kontrollit ndaj shpenzimeve, bashkë me kornizën solide të menaxhimit me rreziqet, nivel të lart të përshtatshmërisë dhe qeverisjes korporative transparente. Banka beson se kjo strategji i mbron interesat e të gjitha palëve të saj të prekura.

2. PROCEDURA PËR THIRRJEN E KUVENDIT, PROCEDURA E VOTIMIT, TË DREJTAT E AKSIONARËVE PËRFSHIRË EDHE TË DREJTËN E AKSIONARËVE PAKICË

2.1 Procedura për thirrjen e Kuvendit

Kuvendi i Bankës është organi më i lart i Bankës dhe atë e përbëjnë aksionarët e Bankës, respektivisht përfaqësuesit e tyre.

Kuvendi i Bankës mbledhet së paku një herë në vit. Kuvendi vjetor i Bankës domosdoshmërisht mbahet para kalimit të gjashtë muajve të vitit kalendarik, për vitin e kaluar. Kuvendin e Bankës, ndërmjet dy Kuvendeve vjetore mund ta thërrasin, Këshilli drejtues paraparakisht duke siguruar mendim/leje nga Këshilli mbikqyrës, ose Këshilli mbikqyrës me iniciativë personale ose me kërkesë të aksionarëve që kanë së paku 1/10 të aksioneve me të drejtë vote.

Kërkesa për thirrjen e Kuvendit në formë të shkruar nga aksionarët që kanë së paku 1/10 të aksioneve me të drejtë vote e përmban qëllimin dhe arsyet e thirrjes së Kuvendit, çështjet mbi të cilat do të vendoset dhe të dhëna për aksionarët që kërkojnë thirrjen e Kuvendit. Kërkesa dërgohet deri te Këshilli drejtues i Bankës në selinë e Bankës, i cili është i obligueshëm në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës të sjell vendim për pranimin apo refuzimin e kërkesës, me çrast në vendimin për refuzim duhet të shënohen arsyet se pse është vendosur ashtu.

Nëse me kërkesë të aksionarëve që kanë shumicë nga të gjithë aksionet me të drejtë vote, Këshilli drejtues i Bankës nuk e thërret Kuvendin në afat prej 24 orëve nga dita e deponimit të kërkesës, aksionarët i realizojnë të drejtat e tyre në pajtim me Ligjin mbi shoqëritë tregtare.

Mbledhjen e Kuvendit e thërret Këshilli mbikqyrës i cili e propozon edhe rendin e ditës të mbledhjes. Në mbledhje thirren të gjithë pronarët e aksioneve.

Kuvendi i Bankës mund të thirret me anë të ftesës apo duke shpallur thirrje publike ose me të dyjat.

Mënyrën e thirrjes së mbledhjes së Kuvendit të Bankës e përcakton Këshilli mbikqyrës i Bankës. Nëse mbledhja e Kuvendit thirret duke dërguar ftesa deri te të gjithë aksionarët, kjo duhet të jetë në atë mënyrë që mundëson vërtetim se ftesa është pranuar nga akcionari, kurse nëse mbledhja e Kuvendit thirret me shpallje publike, e njehta publikohet në gjysmë faqe, së paku në një gazetë ditore që del në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Afati që rrjedh nga dita e shpalles së thirrjes publike, respektivisht nga dita e dërgimit të ftesave për pjesëmarrje në Kuvend deri në ditën e mbajtjes së Kuvendit nuk mund të jetë më i shkurtë se 30 ditë, nga dita e mbajtjes së Kuvendit. Çdo akcionar, pjesëmarrjen e tij në Kuvend e paraqet më së voni para fillimit të mbledhjes së Kuvendit të thirrur. Para fillimit të mbledhjes së Kuvendit, aksionarët njihen me listën në dispozicion mbi aksionarët prezent dhe të paraqitur, personalisht ose nëpërmjet autorizuesit dhe me Listën e aksionarëve që kanë votuar me anë të korrespondencës. Këto lista krahasohen me gjendjen nga libri i aksionarëve të marrë nga CDHV, 48 orë para mbajtjes së mbledhjes së thirrur të Kuvendit.

2.2 Procedura e votimit

Kuvendi kryen punë të përcaktuara me Statutin e Bankës dhe aktet ligjore. Kuvendi mund të vendos vetëm për çështje që me rregull janë të miratuara në rendin e ditës. Kuvendi mund të diskutojë, pa të drejtë vendimi edhe për çështje që nuk janë të futura me rregull në rendin e ditës.

Kuvendi mund të punojë (kuorumi për punë) nëse në seancë marrin pjesë pjesëmarrës të verifikuar në Kuvend që posedojnë shumicë të paktë nga numri i përgjithshëm i aksioneve me të drejtë vote.

Nëse në Kuvend nuk sigurohet ky kuorum, Kuvendi nuk mund të fillojë me punë dhe për një kohë jo më gjatë se 15 ditë thirret kuvend i ri (i rithirrur). Termi i ri i rithirrjes së Kuvendit shpallet në mënyrën e njejtë sikur se thirrja e Kuvendit që nuk kishte kuorum për punë. Në Kuvendin e rithirrur mund të vendoset vetëm për çështje të vendosura në rendin e ditës të Kuvendit të parë, pa marrë parasysh numrin e aksionarëve prezent dhe numrin e aksioneve që posedojnë, përveç për çështje që në pajtim me Ligjin dhe Statutin, vendoset me shumicë më të madhe nga kuorumi i lartpërmendur.

Në rast se ndodh ndërprerje të mbledhjes së Kuvendit që ka filluar me punë, aksionarët e pranishëm në mbledhjen e kuvendit mund të vendosin mbi kohën dhe vendin me shumicë votash nga kuorumi për punë të kuvendit ose në rast se nuk miratohet vendimi paraprakisht i caktuar, kryesuesi i kuvendit e përcakton kohën dhe vendin e vazhdimit të mbledhjes së ndërprerë.

Pjesëmarrja në vazhdimin e mbledhjes së ndërprerë të kuvendit, nuk paraqitet përsëri. Aksionari i cili nuk është paraqitur në mbledhjen e kuvendit e cila është ndërprerë, ka të drejtë të paraqes pjesëmarrjen e tij para fillimit të vazhdimit të mbledhjes së ndërprerë sipas gjendjes në librin e aksionarëve dhe përsëri bëhet nënshkrimi në listën e aksionarëve të paraqitur dhe e njëjta arkivohet nga ana e kryesuesit dhe nëpunësit të procesverbalit.

Nëse në mbledhjen e vazhduar nuk ka kuorum për punë ose nuk mbahet në afat prej 8 ditëve nga dita e ndërprerjes, rithirret kuvend i ri sipas kushteve, mënyrave dhe procedurave të përcaktuara, ndërsa vendimet e miratuara deri në atë moment në mbledhjen e ndërprerë, pa marrë parasysh a do të vazhdohet mbledhja, konsiderohen si të plotëfuqishme.

Kuvendi i Bankës vendos me 2/3 (dy të tretat) nga aksionet me të drejtë vote të përfaqësuara në Kuvend për: ndryshimin dhe plotësimin e statutit, rritjen apo uljen e kryegjësë themelore të Bankës, ndryshimet statutore, ndryshimin e ndërmarrjes dhe selisë së Bankës dhe për raste të tjera të përcaktuara me ligj.

Kuvendi i Bankës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Bankës vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i aksioneve me të drejtë vote.

Votimi në Kuvend sipas rregullit është publike, përveç nëse me Ligj për disa çështje ose raste të caktuara nuk kërkohet detyrimisht të votohet ndryshe.

Banka, aksionerëve mund t'ju mundësojë të votojnë me korrespondencë para ditës së mbajtjes së Kuvendit, me çka detajisht është e rregulluar në Statutin e Bankës.

2.3 Të drejtat e aksionarëve, përfshirë edhe të drejtat e aksionarëve pakicë

Aksionarët e Bankës kanë të drejtë vote, varësisht nga numri i aksioneve me të drejtë vote. Anëtar i Këshillit mbikqyrës dhe Këshillit drejtues mund të marrë pjesë në punën e Kuvendit, pa të drejtë vote, përveç nëse janë aksionarë.

Aksionarët e Bankës i kanë të gjitha të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë, të përcaktuara me aktet dhe Statutin e Bankës.

Aksionarët kanë të drejtë:

- në pjesëmarrje dhe vendimmarrje në Kuvend,
- në dividendë,
- në arkëtim të pjesës së masës së likuidimit apo falimentimit,
- në informim mbi gjendjen e Bankës,
- në mbrojtjen e të drejtave para gjykatave

- në qasje mbi të dhënat të regjistruara në librin e aksionarëve të Bankës, të marrin kopje për këto të dhëna, si dhe qasje dhe kopje nga aktet dhe dokumentat e Bankës (statute dhe aktet tjera, si dhe të gjithë ndryshimet dhe plotësimet, bashkë me tekstet e pastruara, procesverbale dhe dokumente të tjera nga të gjithë kuvendet e aksionarëve); procesverbale dhe vendime nga takimet e organeve të udhëheqjes, respektivisht të këshillit mbikqyrës; llogaritë vjetore dhe raportet financiare që duhet të ruhen sipas ligjit; shtojca (dokumente dhe argumente) që janë deponuar në regjistrin tregtar; të gjithë thirrjet publike dhe prospekte për emetimin e aksioneve dhe letrave tjera me vlerë të shoqërisë; korrespondencën e tërësishme të shkruar të shoqërisë me aksionerët e saj; listën e azhurnuar me emra dhe mbiemra dhe adresa të anëtarëve të zgjedhur të organeve të udhëheqjes, respektivisht këshillit mbikqyrës; dokumente mbi pengun dhe hipotekat; raportin e revizorit të autorizuar dhe raportin e vlerësuesit të autorizuar; fletët e votimit dhe autorizimet për pjesëmarrje në kuvend original apo kopje; kontratën kolektive në nivel të shoqërisë dhe akte dhe dokumente të tjera të parashikuara me ligj dhe me statut.

Aksionarët që individualisht apo bashkë posedojnë të paktën 5% nga numri i përgjithshëm i aksioneve me të drejtë vote kanë të drejtë në formë të shkruar apo elektronike të propozojnë:

- plotësim të rendit të ditës me kërkesë për përfshirjen e pikave të reja, nëse në të njëjtën kohë paraqesin arsyetim mbi pikën e propozuar për plotësim të rendit të ditës me pika të reja ose nëse paraqesin vendim mbi pikën e propozuar
- miratim të vendimeve për secilën mbi pikat që janë të përfshira ose do të përfshihen në rendin e ditës së mbledhjes.

Kërkesa për përfshirjen e pikave në rendin e ditës të Kuvendit dhe/ose propozimin e vendimeve për miratim dërgohet deri te Këshilli drejtues i Bankës, respektivisht deri te thirrësi i Kuvendit në afat prej tetë ditëve nga dita kur është dërguar ftesa, respektivisht nga dita kur është shpallur thirrje publike për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Bankës.

Nëse këto kërkesa të aksionarëve rezultojnë ndryshime të rendit të ditës të mbledhjes së Kuvendit që veç është dërguar, respektivisht i shpallur aksionarëve, Banka e vë në dispozicion rendin e ditës të reviduar në të njëjtën mënyrë sikur rendi i mëparshëm i ditës, para datës së mbajtjes së mbledhjes. Rendi i reviduar i ditës me rregullshmëri është i vënë në dispozicion, nëse aksionarët mundën në kohë të autorizojnë autorizues ose të votojnë me korrespondencë.

Aksionarët kanë të drejtë të parashtrajnë pyetje për çdo pikë të rendit të ditës në mbledhjen e Kuvendit, kurse Banka është e obligueshme të përgjigjet pyetjeve të parashtruara nëpërmjet organit të autorizuar apo përfaqësuesit. Obligimi i Bankës për përgjigje mundet paraprakisht të kushtëzohet me konfirmimin e identitetit personal të aksionarëve që kanë parashtruar pyetje, mbajtjen e rendit në udhëheqjen dhe punën e Kuvendit ose ndërmarrjen e aktiviteteve për ruajtjen e konfidencës dhe interesave afariste të bankës.

Banka mund të jep përgjigje të përmbledhur për pyetjet me përmbajtje të njëjtë. Pyetjet e parashtruara nga aksionarët llogariten se janë përgjigjur nëse përgjigjet janë në dispozicion në internet faqen e bankës në formën e pyetjeve dhe përgjigjeve.

Çdo aksionar mund të autorizojë me fletëautorizim person tjetër juridik apo fizik si autorizues të tij në Kuvendin e Bankës, i cili do të participojë dhe do të votojë në mbledhjen e kuvendit në emër të tij. I autorizuari i kënaq të drejtat e njejta si akcionari nga i cili është i autorizuar me fletëautorizim.

Nëse me Ligjin mbi shoqëritë tregtare nuk është ndryshe e parashikuar autorizimi i përfaqësuesit të autorizuar për mbledhjen e Kuvendit të Bankës, jepet në formë të shkruar, e vërtetuar në noter.

Fletëautorizimi mund të jepet vetëm për një seancë të Kuvendit.

Aksionari duhet ta informojë Bankën me shkrim për emërimin e përfaqësuesit të autorizuar të tij për mbledhjen e Kuvendit të Bankës.

I autorizuari mund të autorizohet nga një ose më shumë aksionarë, kurse numri i aksionarëve që mund të autorizojnë një person të njëjtë nuk është i kufizuar.

Kur përfaqësuesi i autorizuar është i autorizuar nga më shumë aksionarë ai mund të veprojë dhe të votojë ndryshe për ndonjë akcionar për dallim me ndonjë akcionar tjetër.

Banka orvatet që të drejtat dhe interesat e aksionarëve pakicë të respektohen, posaçërisht të drejtën për të thirrur Kuvend, të propozojnë pika në rendin e ditës, të parashtrajnë pyetje në lidhje me rendin e ditës, të përfshihen në diskutim, të japin vërejtje Kuvendit dhe të njejtat të futen në procesverbalin e Kuvendit, dhe veçanërisht në sjelljen e Vendimeve me shumicë kualifikuese.

3. BASHKËPUNIMI NDËRMJET KËSHILLIT MBIKQYRËS DHE DREJTUES, LLOJI, AFATET DHE MËNYRAT SE SI KËSHILLI DREJTUES DORËZON INFORMACIONE DHE DOKUMENTE DERI TE KËSHILLI MBIKQYRËS DHE MËNYRA E VEPRIMIT NË SITUATA KUR EKZISTON KONFLIKT INTERESI

Këshilli drejtues dhe Këshilli mbikqyrës i Bankës bashkëpunojnë në bazë të përhershme, kurse bashkëpunimi në veçanti ka të bëjë në:

- definimin e qëllimeve afariste të Bankës;
- strategjinë për ndërmarrjen dhe udhëheqjen me rreziqet;
- profilin e rrezikshmërisë së Bankës dhe
- politikat për realizimin e qëllimeve afariste dhe qëllimeve në raport me profilin e rrezikshmërisë së Bankës

Këshilli drejtues dhe Këshilli mbikqyrës mbajnë takime të rregullta (të paktën një herë në 3 muaj). Këshilli drejtues i dërgon Këshillit mbikqyrës raport për punën e saj, të paktën një herë në 3 muaj. Nëse vie deri te ndonjë ngjarje me rëndësi të madhe, repektivisht në rastet të përcaktuara me rregullativën ligjore, Këshilli drejtues me urgjencë do ta informojë Këshillin mbikqyrës (raport i jashtëzakonshëm), edhe atë për:

- aftësi të përkeqësuar të pagesës dhe likuiditetit të Bankës;
- ekzistim të kushtit për abrogimin e lejes për themelim apo punë ose për ndalim të ekzistimit të të ndonjë aktiviteti financiar në pajtim me Ligjin;
- uljen e nivelit të parashikuar të mjeteve vetanake në pajtim me Ligjin mbi bankat
- konkludimet e supervizionit dhe mbikqyrjes nga ana e BPRM;
- konkludimet e Drejtorisë për të hyra publike dhe organeve tjera të kontrollit.

Përveç në rastet e njoftimit urgjent të Këshillit mbikqyrës, Këshilli drejtues e njofton edhe për ndryshimet në punë e që janë të rëndësishme për kompetencat e Këshillit mbikqyrës, respektivisht për:

- ndryshime në menaxhimin me rreziqet;
- ndryshime në aftësinë e pagesave dhe gjendjen e likuiditetit të Bankës dhe gjendjen e saj financiare;
- tejkalimin e limiteve të ekspozimit dhe papërputhshmëri në punën me aktet;
- mangësi në sistemin e kontrollit dhe në mënyrën e funksionimit të funksioneve të kontrollit;
- raste të cilat mund të shkaktojnë mosrespektim ose papërputhshmëri me aktet ligjore dhe kërkesat rregullatore dhe
- raste lidhur me raportimin e mbrojtur nga ana e ndonjë raportuesi në Bankë.

Anëtar i Këshillit drejtues është i obligueshëm ta informojë Këshillin mbikqyrës nëse ai ose me të persona të tjerë të ndërlidhur arrijnë kontroll mbi ndonjë subjekt tjetër juridik.

Sipas principit për udhëheqje të mirë korporative, udhëheqja me Bankën realizohet me anë të diskutimit të hapur ndërmjet Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikqyrës si dhe në vetë trupat brenda tyre. Bashkëpunimi ndërmjet Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikqyrës është në drejtim të realizimit të kahjeve strategjike të

Bankës, kurse periodikisht hapet diskutim mbi përparimin e arritur në zbatimin e strategjisë të përcaktuar me politikën afariste, planin zhvillues të Bankës, planin financiar të bankës dhe sistemin e kontrollit të brendshëm. Në këtë kontekst, Këshilli drejtues së paku një herë në vit paraqet deri te Këshilli mbikqyrës Raport mbi vendosjen dhe efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Bashkëpunimi ndërmjet Këshillit drejtues dhe mbikqyrës të Bankës është i dokumentuar, respektivisht banka disponon me këtë dokumentacion:

- Rregullore për punën e Këshillit mbikqyrës, në mënyrë siç është përcaktuar në Statutin e Bankës, në të cilën qartë janë të definuara procedura e punës, obligimet dhe përgjegjësitë e Këshillit mbikqyrës;
- Rregullore për punën e Këshillit drejtues, në mënyrë siç është përcaktuar në Statutin e Bankës, në të cilën qartë janë definuar procedura e punës, obligimet dhe përgjegjësitë e Këshillit drejtues;
- procesverbale nga mbledhjet e mbajtura të Këshillit mbikqyrës dhe Këshillit drejtues;
- dokumentacion tjetër në bazë të së cilës mund të vlerësohet puna e Këshillit mbikqyrës dhe Këshillit drejtues;

Nëse një anëtar individual i Këshillit mbikqyrës vlerëson se vendimet e sjellura të Këshillit mbikqyrës janë në kundërshtim me qëllimet afariste, strategjitë dhe politikat e Bankës dhe në kundërshtim me përgjegjësitë dhe detyrat e këtij organi, mendimin e tij e shpreh në formë të shkruar me arsyetim përkatës dhe e cila është e përfshirë në Procesverbalin e mbledhjes së Këshillit mbikqyrës.

Nëse një anëtar individual i Këshillit drejtues vlerëson se vendimet e sjellura të Këshillit drejtues janë në kundërshtim me qëllimet afariste, strategjitë dhe politikat e Bankës dhe në kundërshtim me përgjegjësitë dhe detyrat e këtij organi, mendimin e tij e shpreh në formë të shkruar me arsyetim përkatës.

Këshilli drejtues së paku një herë në vit përpilon raport për punën e tij dhe e dërgon në shqyrtim deri te Këshilli mbikqyrës. Këshilli mbikqyrës, së paku një herë në vit kryen vlerësimin e punës së Këshillit drejtues të Bankës, me çrast bazë fillestare paraqet politika afariste dhe plani i punës i Bankës, në të cilin evidentohet mendimi i Këshillit mbikqyrës për plotësimin e planeve, fushave ose pjesëve të planit që do mundej më mirë të plotësoheshin, dhe propozon shpërblim eventual të Këshillit drejtues në pajtim me politikën e shpërblimit.

Këshilli mbikqyrës deri në Kuvendin e Bankës dërgon Raport vjetor për punën e tij. Ky raport i përmban këto të dhëna:

- mënyra e realizimit të funksionit mbikqyrës;
- bashkëpunimi me Këshillin drejtues;
- organizimi i brendshëm dhe struktura e Këshillit mbikqyrës;
- ekzistimi i konfliktit eventual të interesit dhe mënyra si është rregulluar;
- rezultatet nga vlerësimi i punës personale nga aspekti i anëtarëve individual dhe kolektivisht;
- prezenca e çdo anëtari në veçanti në mbledhjet e Këshillit mbikqyrës të Bankës dhe
- kryerjen e punëve tjera në pajtim me Ligjin.

Këshilli mbikqyrës së paku një herë në tre muaj e shqyrton Raportin e transaksioneve me persona të ndërlidhur me Bankën, si dhe shumën e përgjithshme të kredive të aprovuara dhe formave të tjera të ekspozimit për/ndaj të punësuarve tjerë në Bankë.

Raporti përmban llojin e transakcionit, shumën e transakcionit dhe kategorinë e rrezikshmërisë, nëse bëhet fjalë për kredi të aprovuar dhe formë tjetër të ekspozimit ndaj personit të ndërlidhur me Bankën dhe të punësuarit e saj.

Këshilli mbikqyrës e aprovon Kodin etik të Bankës të cilin e përgadit Këshilli drejtues. Kodi etik paraqet përmbledhje të standardeve profesionale dhe vlerave korporative të cilët njejte do të zbatohen ndaj të

gjithë anëtarëve të Këshillit mbikqyrës, Këshillit drejtues dhe personave me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme dhe të punësuarve në Bankë, në të cilën është e rregulluar kjo:

- shmangia e rasteve të konfliktit të interesit;
- shmangia e rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve të tjera joetike dhe joligjore;
- transaksione me persona të ndërlidhur me Bankën dhe
- ruajtja e fshehtësisë bankare.

Këshilli drejtues, në bazë të Kodit etik të Bankës, përgadit politika dhe procedura, me të cilat identifikohen konfliktet potenciale të interesit dhe definoohen masat dhe aktivitetet që ndërmerren në rastet e konfliktit të interesit. Këtë politikë e aprovon Këshilli mbikqyrës.

Këshilli mbikqyrës dhe Këshilli drejtues vendosin politika dhe procedura për komunikim të pandërprerë dhe mundësi të informimit për cilin do të punësuar në Bankë për rastet e korrupsionit dhe sjelljeve dhe aktiviteteve tjera joetike dhe joligjore, me çrast sigurojnë mbrojtje të drejtave të punësuarve të cilët kanë raportuar për paraqitjen e këtyre rasteve. Këto raportime të punësuarit i dërgojnë deri te Drejtoria për revizion të brendshëm, personi për kontrollin e përputhshmërisë në punën e Bankës me aktet dhe Drejtorinë për resurse njerëzore.

Anëtarët e Këshillit mbikqyrës dhe drejtues çdo gjashtë muaj japin deklaratë të shkruar për egzistimin/mosegzistimin e konfliktit të interesit të tyre me interesin e Bankës. Me interes personal të anëtarëve të Këshillit mbikqyrës dhe Këshillit drejtues nënkuptohen edhe interesat e personave të ndërlidhur me to. Anëtarët e Këshillit mbikqyrës dhe Këshillit drejtues nuk guxojnë të marrin pjesë gjatë marrjes së vendimeve, të nënshkruajnë kontrata ose të kryejnë aktivitete të tjera afariste, nëse objektiviteti i tyre është në pikëpyetje për arsye të egzistimit të interesit të tyre personal me interesin e Bankës. Për egzistimin e konfliktit të interesit, anëtarët e Këshillit mbikqyrës dhe Këshillit drejtues japin deklaratë të shkruar edhe para mbajtjes së mbledhjes për shqyrtimin dhe sjelljen e vendimeve, nënshkrimin e kontratave ose kryerjen e aktiviteteve të tjera afariste dhe të njejtën e paraqesin deri te Këshilli mbikqyrës dhe drejtues, kurse në të e evidentojnë edhe bazën nga e cila buron konflikti ndërmjet interesit personal dhe interesit të Bankës.

4. OBLIGIMET DHE PËRGJEGJËSITË E KËSHILLIT MBIKQYRËS, KËSHILLIT DREJTUES DHE ORGANEVE TË TJERA DHE MËNYRA E VEPRIMTARISË SË TYRE

4.1. Obligimet, përgjegjësitë dhe mënyra e veprimtarisë së Këshillit mbikqyrës

Këshilli mbikqyrës e ka përgjegjësinë kryesore për krijimin e kushteve për punë dhe qeverisje të mirë të bankës dhe për stabilitetin e saj. Këshilli mbikqyrës kryen mbikqyrje të punës së Këshillit drejtues, i aprovon politikat për kryerjen e aktiviteteve financiare dhe e përcjell zbatimin e tyre. Këshilli mbikqyrës është përgjegjës që të sigurojë punë, udhëheqje dhe stabilitet të mirë të Bankës dhe informim në kohë dhe të saktë ndaj BPRM-së.

Këshilli mbikqyrës i bankës i kryen këto punë:

1. miraton politikën afariste të Bankës dhe planin zhvillues të saj;
2. miraton planin financiar të Bankës;
3. përcakton propozime të akteve që i sjell Kuvendi dhe i ekzekuton aktet e Kuvendit
4. shqyrton dhe aprovon raporte për veprimtarinë e Bankës gjatë vitit vijues
5. Kuvendit i propozon vendim për përdorimin dhe shpërndarjen e fitimit të realizuar, respektivisht për mbulimin e humbjeve
6. miraton politikën e shpërblimit, në përputhje me politikën afariste, planin financiar dhe politikën për shmangien e konfliktit të interesit në bankë
7. sjell dhe zbaton politika për mënyrën e zgjedhjes, ndjekjes së punës dhe shkarkimit të anëtarëve të këshillit mbikqyrës, këshillit për menaxhim me rreziqe. këshillit për revizion dhe këshillit drejtues

8. shqyrton raportet e kontrollit supervisor, raporte të tjera dërguar BPRM-së, Drejtorisë për të Hyra publike dhe institucioneve tjera kompetente dhe propozon/ndërmerr masa dhe aktivitete për tejkalimin e dobësive dhe mospërputhshmërive
9. e organizon shërbimin për kontroll dhe revizion të brendshëm, i emëron dhe shkarkon të punësuarit në shërbim, aprovon planin vjetor të shërbimit për kontroll dhe revizion të brendshëm, aprovon politikat dhe procedurat për kryerjen e revizionit të brendshëm dhe shqyrton Raportin e Këshillit drejtues mbi vendosjen dhe efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
10. miraton politikën për siguri të sistemit informatik, kryen vlerësim të përshtatshmërisë së tij së paku një herë në vit nga aspekti i ndryshimeve të ndodhura në strukturën organizacionale dhe ndryshimet në sistemin informatik në bankë dhe përcjell efikasitetin e procesit të udhëheqjes me sistemin informatik nëpërmjet analizave të rezultateve nga testimet e kontroleve të sigurimit në sistemin informatik;
11. miraton politikat për menaxhim me rreziqet e Bankës; kryen vlerësime të sistemeve për menaxhim me rreziqet, përcakton strategji afatshkurta dhe afatgjata për menaxhim me llojet e caktuara të rreziqeve në të cilën është e ekspozuar;
12. emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit për revizion
13. emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit drejtues;
14. emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit për menaxhimin me rreziqet;
15. e miraton propozimin e Këshillit drejtues për emërimin dhe shkarkimin e Drejtorëve të Drejtorisë për menaxhim me rreziqe, Drejtorisë për çështje juridike dhe Drejtorisë për kontroll të brendshëm
16. e miraton llogarinë vjetore dhe raportet financiare të bankës
17. shqyrton Raportet e Këshillit drejtues, kryen vlerësim të punës së Këshillit drejtues dhe propozon shpërblim apo masa të tjera eventuale për Këshillin drejtues
18. shqyrton raportet e Këshillit për menaxhim me rreziqet, Këshillit për revizion, personit për kontroll të përputhshmërisë së punës së Bankës me aktet;
19. miraton përvetësimin e pjesëve kapitale dhe blerjen e letrave me vlerë, më të mëdha se 5% nga mjetet personale të Bankës, përveç blerjes së letrave me vlerë të lëshuara nga BPRM dhe nga Republika e Maqedonisë;
20. me akt të veçantë përcakton mënyrën dhe kushtet për emetimin e derivateve financiare;
21. miraton ekspozim kreditor ndaj personave fizik apo juridik ose ekspozim të tërësishëm ndaj personave të ndërlidhur fizik apo juridik në mbi 20% nga mjetet vetanake të Bankës
22. i përcakton kompetencat dhe limitet e ekspozimeve kreditore që aprovohen në kuadër të Këshillit kreditues të Bankës dhe Këshillit për menaxhim me rreziqe
23. aprovon transaksione me persona të ndërlidhur me Bankën në shumë mbi 6.000.000 denarë, shqyrton raportin për transaksione me persona të ndërlidhur me Bankën si dhe raportin për shumën e përgjithshme të kredive të lejuara dhe formave tjera të ekspozimit të/ndaj të punësuarve të tjerë në Bankë
24. vendos për çregjistrim të kërkesave problematike
25. miraton propozimin e Këshillit për revizion për emërimin e Shoqatës për revizion dhe shkarkimin e saj dhe është përgjegjëse për sigurimin e revizionit përkatës
26. Kuvendit i paraqet raport mbi punën;
27. thërret mbledhje të Kuvendit dhe propozon rendin e ditës;
28. miraton emetimin e letrave me vlerë përveç aksioneve;
29. Kuvendit i propozon emetimin e aksioneve;
30. vendos për blerjen ose tjetërsimin e paluajtshmërive, shuma e të cilave nuk e kalon shumën prej 50% të kapitalit garantues të Bankës dhe autorizon Këshillin drejtues për zbatimin e saj;
31. vendos për themelimin e përfaqësive dhe degëve jashtë vendit dhe investimin në subjekte të tjera juridike në vend dhe jashtë vendit;
32. kujdeset për projektimin e likuiditetit të Bankës dhe ndërmerr masa për qëndrueshmërinë e tij;
33. vendos për rreshtimin dhe strukturën organizacionale të brendshme të Bankës dhe ndryshimin e saj (skema organizacionale) si dhe për hapjen dhe mbylljen e degëve, ekspoziturave dhe formave tjera organizacionale të Bankës;

34. formon këshilla dhe komisione për shkak të realizimit ose hulumtimit të ndonjë çështje të caktuar nga veprimtaria e Bankës;
35. sjell akte të përgjithshme për punën e Bankës dhe akte të marrëdhënieve të punës;
36. vendos në shkallë të dytë ndaj ankesave të vendimeve të Këshillit drejtues të Bankës dhe kryen rishqyrtim të vendimeve personale;
37. emëron dhe shkarkon anëtarë të Këshillit kreditues të Bankës;
38. shqyrton raportet për kërkesat e ristrukturuara si dhe raportet tek të cilat është vazhduar afati i maturimit;
39. miraton propozimin e Këshillit drejtues për thirrjen e Kuvendit dhe jep vlerësim deri te Këshilli drejtues për thirrjen e kuvendit me iniciativë të aksionarëve;
40. aprovon aktin e Këshillit drejtues me të cilin rregullohet përfaqësimi dhe nënshkrimi i akteve të Bankës;
41. miraton Politikën për identifikimin e konfliktit të interesit me të cilat identifikohen konfliktet e mundshme të interesit dhe masat dhe aktivitetet për zgjidhjen e tij;
42. aprovon Programin për parandalimin e korrupsionit;
43. e miraton Kodin etik të Bankës;
44. e miraton Kodin për qeverisje korporative
45. aprovon Politikën mbi zbatimin e vazhdueshëm dhe efikas të kontrollit për përputhshmërinë e punës së Bankës me aktet;
46. aprovon Politikën mbi publikimin e raporteve dhe të dhënave nga ana e Bankës;
47. aprovon Politikën për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit drejtues, të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta që kryejnë funksione udhëheqëse dhe të punësuarve në Bankë;
48. shqyrton raportet mbi profilin e rrezikshmërisë së Bankës, aprovon limitet e ekspozimit të disa llojeve të rrezikut dhe aprovon vendosjen e rreziqeve të reja të cilët kanë ndikim të konsiderueshëm mbi profilin e rrezikshmërisë së Bankës
49. themelimin e pengut ose çfarëdo lloj tjetër të barrës të cilës do pjesë të pronës së Bankës si kolateral dhe të jetë borxh në shumë mbi 250.000 euro.
50. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Statut, aktet e tjera të Bankës, Ligjin dhe rregullativën nënligjore e që nuk janë nën kompetencën e Kuvendit.

Në rast se aktet interne të miratuara nga ana e Këshillit mbikqyrës janë rezultat i akteve interne të grupit që i përket banka, Këshilli mbikqyrës është i obliguar të sigurojë që ato akte të jenë adekuate me bankën dhe të jenë të përshtatura me rregullativën ligjore në Republikën e Maqedonisë.

Këshilli mbikqyrës është i obliguar që ta vlerësojë përshtatshmërinë e akteve interne që ka miratuar dhe të kryejë revidimin e tyre të rregullt.

Këshilli mbikqyrës së paku një herë në vit kryen vlerësim për punën e vet nga aspekti i anëtarëve në veçanti dhe kolektivisht dhe për të e informon Kuvendin e Bankës.

Këshilli mbikqyrës punon në seancë dhe takohet së paku një herë në 3 muaj. Mbledhjat i thirr dhe me to kryeson Kryetari i Këshillit mbikqyrës. Anëtarët e Këshillit mbikqyrës mund të participojnë dhe të vendosin më seancë të organizuar duke shfrytëzuar lidhje konference apo telefonike ose duke shfrytëzuar pajisje komunikuese tjera audio vizuale. Pjesëmarrja në seancë shënohet në Procesverbalin e Këshillit mbikqyrës të cilin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët që marrin pjesë në takim.

Thirrja e mbledhjes mund të bëhet edhe me kërkesë të Këshillit drejtues të Bankës. Anëtarët e Këshillit mbikqyrës ftohen në mbledhja dhe të gjithë materialet dorëzohen tek anëtarët së paku 5 ditë më herët para datës së mbledhjes së Këshillit mbikqyrës.

Kryetari i Këshillit mbikqyrës mund të realizojë edhe mbledhja urgjente të Këshillit mbikqyrës, kurse materialet e rendit të ditës së mbledhjes përkatëse, mund të dotëzohen edhe në ditën e mbajtjes së mbledhjes.

Këshilli mbikqyrës mund të vendos edhe pa mbajtur seancë, nëse të gjithë anëtarët japin pëlqim për vendimin që sillet pa mbajtur takim. Këto vendime hyjnë në fuqi me ditën e dhënies së pëlqimit nga ana e të gjithë anëtarëve të Këshillit mbikqyrës, me nënshkrim personal, nënshkrim dërguar me faks ose me rrugë elektronike, përveç në rastet kur në vendim është përmendur datë tjetër e hyrjes në fuqi. Për të gjithë vendimet e sjellura në këtë mënyrë përgaditet Procesverbal në të cilën evidentohen vendimet dhe të cilin e nënshkruan Kryetari i Këshillit mbikqyrës kurse në mungesë të tij anëtarë tjetër i Këshillit mbikqyrës. Procesverbali përgaditet në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e dhënies së pëlqimit.

Me rregulloren e punës së Këshillit mbikqyrës më së afërti rregullohen thirrjet e mbledhjeve, mënyra e punës, procedurat e vendimmarrjes, koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjeve, plotësimi i procesverbalit, mënyra e votimit dhe çështje tjera me rëndësi për punën e Këshillit mbikqyrës në pajtim me Ligjin. Këshilli mbikqyrës mbahet, nëse në seancë janë prezent më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve, kurse vendime të plotëfuqishme sjell nëse për vendimin kanë votuar shumica e anëtarëve të Këshillit mbikqyrës. Vendimet e Këshillit mbikqyrës miratohen me votim publik, nëse Këshilli mbikqyrës nuk ka vendosur ndryshe.

4.2. Obligimet, përgjegjësitë dhe mënyra e punës së Këshillit drejtues

Në pajtim me kompetencat e parashikuara në Ligjin mbi bankat, Këshilli drejtues menaxhon me bankën dhe është i përfshirë në zbatimin e politikës afariste, vendosjen dhe promovimin e kulturës dhe vlerave korporative, përcaktimin e nivelit të pranueshëm të rrezikshmërisë. Këshilli drejtues e paraqet dhe e përfaqëson Bankën dhe udhëheq me punën e saj.

Këshilli drejtues i kryen këto punë:

1. Udhëheq me Bankën
2. E përfaqëson Bankën
3. I ekzekuton Vendimet e Kuvendit dhe Këshillit mbikqyrës të Bankës, respektivisht kujdeset për zbatimin e plotë të tyre
4. Miraton dhe zbaton politika për mënyrën e zgjedhjes, ndjekjen e punës dhe shkarkimin e personave të tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, përveç oper anëtarët e këshillit mbikqyrës, këshillit për menaxhim me rreziqe, këshillit për revizion dhe këshillit drejtues
5. Nxit iniciativa dhe jep propozime për avancimin e veprimtarisë së Bankës
6. Emëron dhe shkarkon persona me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, nëse me Ligj apo në Statut nuk është parashikuar ndryshe
7. Sjell Vendim për pranim apo ndërprerje të marrëdhënies së punës për të punësuarit e Bankës
8. Sjell Vendim për klasifikimin e të punësuarve në vende të caktuara të punës në kuadër të njëjësive organizacionale të Bankës
9. Përgatit politika afariste dhe plan zhvillimor për Bankën
10. Përgatit plan financiar për Bankën
11. Përgatit politika të sigurisë për sistemin informatik të Bankës
12. Përgatit Raport vjetor për punën e Bankës dhe e dorëzon deri te Këshilli mbikqyrës
13. Sjell vendim për marrje me qira të paluajtshmërive ose pajisjeve për nevojat e Bankës
14. Jep pëlqim për pranimin e nivelimit të dhunshëm në procedurat e falimentimit kundër debitorëve të Bankës dhe për iniciimin e procedurës së falimentimit kundër të njejtëve
15. Përgatit Kodin etik të Bankës
16. Vendos për rilokacionin e degëve, ekspoziturave dhe formave tjera organizacionale të Bankës, dhe ridefinimin e ekspoziturave në degë dhe anasjelltas, me çrast në mbledhjen e parë të ardhshme detyrimisht e informon edhe Këshillin mbikqyrës
17. Propozon themelimin e përfaqësive, degëve dhe formave tjera organizacionale jashtë vendit
18. E aprovon raportin mbi regjistrimin e mjeteve dhe burimeve të mjeteve

19. Sjell aktet e sistematizimit në Bankë

20. Kryen dhe është përgjegjës edhe për punë të tjera me rëndësi për veprimtarinë e Bankës, sipas Ligjit dhe akteve, përveç për ato të cilat janë nën kompetencat e organeve të tjera të Bankës

Këshilli drejtues i Bankës është përgjegjës për:

- Sigurimin e kushteve të punës në Bankë në pajtim me aktet;
- Menaxhimin dhe përcjelljen e rreziqeve në të cilat është ekspozuar Banka në veprimtari;
- Arritjen dhe qëndrueshmërinë e nivelit përkatës të mjeteve personale;
- Funksionimin e sistemit për kontroll të brendshëm në të gjithë fushat e veprimit të Bankës;
- Punën e pandërprerë të shërbimit për revizion të brendshëm të Bankës, respektivisht siguron se shërbimi për revizion të brendshëm ka qasje deri te dokumentacioni dhe të punësuarit e bankës me qëllim të zbatimit të pandërprerë të aktiviteteve të tyre;
- Punën e papenguar të personit, respektivisht shërbimit të kontrollit mbi përputhshmërinë e punës së Bankës me aktet, siguron se personi, respektivisht shërbimi ka qasje deri te dokumentacioni dhe të punësuarit e bankës me qëllim të zbatimit të papenguar të autorizimeve;
- Udhëheqjen me librat tregtarë dhe librat e tjerë dhe dokumentacionin afarist të bankës, përgaditjen e raporteve financiare dhe të tjera në pajtim me aktet e kontabilitetit dhe standardeve të kontabilitetit;
- Informimin financiar të saktë dhe me kohë;
- Rregullshmërinë dhe saktësinë e raporteve që dorëzohen deri te Banka popullore në pajtim me ligjin dhe aktet të sjellura në bazë të ligjit dhe
- Zbatimin e masave të shqiptuara nga ana e guvernatorit kundër bankës.

Këshilli drejtues për punën e tij përgjigjet para Këshillit mbikqyrës.

Këshilli drejtues i Bankës punon dhe vendos në mbledhje (mbledhja).

Këshilli drejtues i Bankës mund të mbaj mbledhje dhe të sjell vendime të plotëfuqishme nëse janë prezent shumica e anëtarëve të Këshillit drejtues. Vendimi i Këshillit drejtues llogaritet si e sjellur nëse për të deklarohen shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Në pajtim me Statutin e Bankës në rast të numrit të barabartë të votave, vota e Kryetarit të Këshillit drejtues të Bankës është vendimtare.

Për shkak të efikasitetit në punë, çdo anëtar i Këshillit drejtues është i autorizuar të vendos respektivisht të zgjidh individualisht në kuadër të fushëveprimit të punës për të cilin është përgjegjës në pajtim me skemën organizacionale të Bankës.

Mbledhjat e Këshillit drejtues mbahen së paku njëherë në javë. Për vijimin e mbledhjes plotësohet Procesverbal i cili përgaditet në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e mbajtjes së mbledhjes. Në mbledhjat e Këshillit drejtues, sipas nevojës mund të marrin pjesë, por pa të drejtë për vendimmarrje edhe persona kompetent të punësuar në Bankë.

Anëtarët e Këshillit drejtues mund të marrin pjesë dhe të vendosin në mbledhja duke shfrytëzuar edhe lidhje konference, telefonike ose duke shfrytëzuar pajisje të tjera komunikuese audio vizuale. Pjesëmarrja në këto mbledhja të mbajtura llogaritet si prezencë edhe prezenca personale e anëtarëve të Këshillit drejtues, të cilët janë të kyqur me anë të lidhjes konferenciëre, telefonike apo duke shfrytëzuar pajisje tjetër komunikuese audio vizuale, me çrast të gjithë personat ë marrin pjesë në kësaj mbledhja të organizuara mund të dëgjohen, të shikohen dhe të bisedojnë njëri me tjetrin.

Pjesëmarrja në mbledhje evidentohet në Procesverbalin e Këshillit drejtues, të cilin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje.

Këshilli drejtues mund të vendos edhe pa mbajtur seancë me çrast të gjithë anëtarët e këshillit japin pëlqim për vendimin që sillen pa mbajtur seancë.

Pëlqimi llogaritet si i dhënë duke nënshkruar Vendimin me nënshkrim personal ose me nënshkrim të dërguar me faks ose me rrugë elektronike në propozimin e vendimit.

Me rregulloren e punës së Këshillit drejtues për së afërmi rregullohen thirrjet e mbledhjeve, mënyra e punës, procedura e vendimmarrjes, koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjeve, plotësimi i procesverbalit, mënyra e votimit dhe çështje të tjera me rëndësi për veprimtarinë e Këshillit drejtues në pajtim me Ligjin.

Ndarja e kompetencave dhe përgjegjësi midis Kryetarit të Këshillit drejtues dhe anëtarëve të Këshillit mbikqyrës të Bankës është kryer në këtë mënyrë:

Kryetari i Këshillit drejtues të Bankës është përgjegjës për punën e tërësishme të Bankës, respektivisht për pjesët organizative që janë nën kompetencë të anëtarëve të Këshillit drejtues dhe për marrëdhëniet me publikun.

Anëtar i Këshillit drejtues të Bankës është përgjegjës për Sektorin e kreditimit, Sektorit të mjeteve, likuiditetit dhe punëve bankare ndërkombëtare dhe Sektorit për resurse njerëzore dhe organizim.

Anëtar i Këshillit drejtues të Bankës është përgjegjës për Sektorin e marketingut dhe Sektorin për operacione dhe sisteme të informacionit.

Anëtar i Këshillit drejtues të Bankës është përgjegjës për Sektorin për arkëtimin e kërkesave të rrezikshme, përputhjes me aktet dhe sigurisë së sistemeve të informacionit dhe Sektorin për qeverisje financiare, planifikim dhe njoftim.

4.3. Obligimet, përgjegjësitë dhe mënyra e punës së Këshillit për menaxhimin me rreziqet

Këshilli për menaxhimin me rreziqet i kryen këto punë:

- në vazhdimësi e përcjell dhe e vlerëson shkallën e rrezikshmërisë së bankës dhe e përcakton nivelin e pranueshëm të ekspozimit me rreziqet me qëllim të minimizimit të humbjeve nga ekspozimi ndaj rreziqeve;
- fut politika për menaxhimin me rreziqet dhe përcjell zbatimin e tyre;
- i përcjell aktet e Bankës popullore që kanë të bëjnë me menaxhimin me rreziqet dhe përputhshmërinë e bankës me këto akte;
- kryen vlerësimin e sistemeve për menaxhimin me rreziqet e bankës;
- përcakton strategji afatshkurta dhe afatgjata për menaxhimin me lloje të veçanta të rreziqeve në të cilën është e ekspozuar banka;
- i analizon raportet mbi ekspozimin e bankës në rrezik të përpiluar nga shërbimet e bankës që kryejnë vlerësim të rreziqeve dhe propozojnë strategji, masa dhe instrumente për mbrojtje nga rreziqet
- e përcjell efikasitetin e sistemeve për kontroll të brendshëm në menaxhimin me rreziqet;
- i analizon efektet nga menaxhimi me rreziqet mbi performancat e bankës;
- kryen vlerësim të përputhshmërisë së çmimeve të produkteve dhe shërbimeve që i ofron banka me nivelin e rrezikut të marrë, në përputhje me politikën afariste dhe planin zhvillimor të Bankës
- në pajtim me Ligjin mbi Bankat, mund të aprovojë ekspozim ndaj personit me mbi 10% deri 20% nga mjetet vetanake të bankës, ndërsa Këshilli mbikqyrës është përgjegjës për ti kufizuar këto limite
- kryen aktivitete të tjera në pajtim me rregullativën ligjore, nënligjore dhe me aktet interne të Bankës

Këshilli për menaxhim me rreziqet së paku një herë në vit kryen vlerësimin e punës së vet nga aspekti i anëtarëve individual dhe kolektivisht dhe për të njejtën dorëzon raport vjetor deri te Këshilli mbikqyrës.

Anëtarët e Këshillit për menaxhimin me rreziqet kanë obligim që individualisht të përcjellin dhe të informojnë për çdo rrezik nga fushëveprimi i punës së tyre.

Këshilli për menxhimin me rreziqet vendos duke sjellur vendime, konkluzione, mendime, qëndrime dhe rekomandime të cilat i nënshkruan kryetari i Këshillit ose personi që e zëvendëson.

Me rregulloren e punës së Këshillit për menaxhimin me rreziqet për së afërmi rregullohen thirrjet e mbledhjave, mënyra e punës, procedura e vendimmarrjes, koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjave, plotësimi i procesverbalit, mënyra e votimit dhe çështje të tjera me rëndësi për veprimtarinë e Këshillit.

Këshilli për menaxhimin me rreziqet takohet së paku njëherë në javë, kurse me kërkesë të Këshillit mbikqyrës ose së paku të dy anëtarëve të tij edhe më shpesh. Këshilli për menxhimin me rreziqet plotëfuqishëm diskuton dhe vendos nëse në seancë janë prezent shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, kurse vendimi llogaritet i sjellur nëse për të votojnë shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit për menaxhimin me rreziqet mund të marrin pjesë dhe të vendosin në mbledhja duke shfrytëzuar edhe lidhje konference, telefonike ose duke shfrytëzuar pajisje të tjera komunikuese audio vizuale. Pjesëmarrja në mbledhje evidentohet në 16 Procesverbalin e Këshillit për menxhimin me rreziqet, të cilin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje.

Për punën e Këshillit për menaxhimin me rreziqet mbahet procesverbal i cili aprovohet në mbledhjen e parë të ardhshme të Këshillit.

Këshilli për menaxhimin me rreziqet mund të vendos edhe pa mbajtur mbledhje, nëse të gjithë anëtarët e Këshillit japin fletëpëlqim për aktin i cili sillet me nënshkrim personal, me nënshkrim të dërguar me faks ose me rrugë elektronike. Për të gjithë aktet të sjellura me fletëpëlqim të anëtarëve të Këshillit përgaditet procesverbal.

4.4. Obligimet, përgjegjësitë dhe mënyra e punës së Këshillit për revizion

Këshilli për revizion i kryen këto punë:

- i shqyrton raportet financiare të Bankës dhe kujdeset për saktësinë dhe transparencën e informacioneve financiare të publikuara për veprimtarinë e Bankës në pajtim me aktet për kontabilitet dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit;
- e përcjell punën dhe e vlerëson efikasitetin e shërbimit për revizion të brendshëm;
- i shqyrton dhe i vlerëson sistemet për kontroll të brendshëm;
- e përcjell procesin e revizionit të Bankës dhe e vlerëson punën e Shoqatës për revizion;
- i sjell politikat e kontabilitetit të Bankës;
- e përcjell përputhshmërinë e veprimtarisë së Bankës me aktet që kanë të bëjnë me standardet e kontabilitetit dhe raportet financiare;
- mban takime me Këshillin drejtues, Shërbimin për revizion të brendshëm dhe Shoqatën për revizion në lidhje me mospërputhshmëri të përcaktuara me aktet dhe dobësitë në punën e Bankës;
- i shqyrton raportet e Këshillit për menaxhimin me rreziqet;
- propozon Shoqatën për revizion dhe
- kryen aktivitete tjera në pajtim me rregullativën ligjore, nënligjore dhe me aktet interne të Bankës.

Këshilli për revizion vepron dhe vendos në mbledhja të cilat i thirr kryetari së paku njëherë në tre muaj ose më shpesh me kërkesë të Këshillit mbikqyrës.

Vendimet e këtij Këshilli sillen me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit. Anëtarët e Këshillit për revizion mund të marrin pjesë dhe të vendosin në seancë të organizuar duke shfrytëzuar lidhje konference, telefonike apo duke shfrytëzuar pajisje tjetër komunikuese audio vizuale.

Këshilli për revizion mund të vendos edhe pa mbajtur mbledhje, nëse të gjithë anëtarët e Këshillit japin fletëpëlqim në aktin që sillet me nënshkrim personal, me nënshkrim të dërguar me faks ose me rrugë elektronike. Për të gjithë aktet të sjellura me fletëpëlqim të anëtarëve të Këshillit përgaditet procesverbal. Për punën e Këshillit për revizion përgaditet procesverbal i cila aprovohet në mbledhjen e parë të ardhshme të Këshillit.

Me rregulloren e punës së Këshillit për revizion për së afërmi rregullohen thirrjet e mbledhjave, mënyra e punës, procedura e vendimmarrjes, koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjave, plotësimi i procesverbalit, mënyra e votimit dhe çështje të tjera me rëndësi për veprimtarinë e Këshillit në pajtim me Ligjin.

Këshilli për revizion së paku njëherë në vit kryen vlerësim për punën e tij nga aspekti i anëtarëve individual dhe kolektivisht dhe dorëzon raport vjetor për punën e tij deri të Kuvendi dhe deri te Këshilli mbikqyrës në të cilën është i përfshirë vlerësimi për punën e tij nga aspekti individual i anëtarëve dhe kolektivisht.

4.5. Obligimet, përgjegjësitë dhe mënyra e punës së Këshillit kreditues

Këshilli kreditues i shqyrton dhe në pajtim me rregullat e Bankës, i aprovon ose i refuzon, kërkesat kredituese të përpiluara në para dhe jo para. Këshilli kreditues punon në mbledhja të cilat i thirr kryetari i Këshillit kreditues, kurse në mungesë të tij i thirr personi që e zëvendëson. Mbledhjat mbahen varësisht nga nevojat.

Anëtarët e Këshillit kreditues të Bankës dhe zëvendësit e tyre, i emëron dhe i shkarkon Këshilli mbikqyrës i Bankës.

Me vendimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit kreditues, emërohen edhe zëvendësit e anëtarëve të Këshillit kreditues nga rradha e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të Bankës. Në rast të mungesës së anëtarëve të Këshillit kreditues, në mbledhjet e Këshillit kreditues do të marrin pjesë dhe do të vendosin zëvendësit e tyre.

Me akt të përgjithshëm të Këshillit mbikqyrës përcaktohet delegimi i autorizimeve të organeve dhe personave të autorizuar për aprovimin e kredive sipas shumës dhe nivelit të tyre të marrjes së vendimit.

Këshilli kreditues plotëfuqishëm diskuton dhe vendos nëse në seancë janë të pranishëm shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit. Këshilli kreditues vendos me shumicë nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit.

Për punën e Këshillit kreditues përgatitet procesverbal.

Këshilli drejtues mund të vendos edhe pa mbajtur mbledhje, nëse të gjithë anëtarët e Këshillit japin fletëpëlqim të aktit që sillet me nënshkrim personal, me nënshkrim të dërguar me faks ode me rrugë elektronike. Për të gjithë aktet e sjellura me fletëpëlqim të anëtarëve të Këshillit përgaditet procesverbal.

Anëtarët e Këshillit kreditues mund të marrin pjesë dhe të vendosin edhe në mbledhja të organizuara duke shfrytëzuar lidhje konference, telefonike apo pajisje tjera komunikuese audio vizuale.

Pjesëmarrja në mbledhje evidentohet në Procesverbalin, të cilin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

Me rregulloren e punës së Këshillit kreditues për së afërmi rregullohen thirrjet e mbledhjave, mënyra e punës, procedura e vendimmarrjes, koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjave, plotësimi i procesverbalit, mënyra e votimit dhe çështje të tjera me rëndësi për veprimtarinë e Këshillit në pajtim me Ligjin.

5. KRITERET DHE RREGULLAT PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE NË KËSHILLIN MBIKQYRËS DHE MËNYRA E SHPËRBLIMIT TË TYRE

Këshilli mbikqyrës përbëhet prej 7 anëtarëve, të cilët i emëron Kuvendi i Bankës me vendim i cili hyn në fuqi pas marrjes së pëlqimit nga Guvernatori i BPRM-së. Së paku dy nga anëtarët e Këshillit mbikqyrës janë anëtarë të pavarur. Mandati i anëtarëve të Këshillit mbikqyrës zgjat 4 (katër) vite me të drejtë të rizgjedhjes.

Anëtarët e Këshillit mbikqyrës nga përbërja e tij në mbledhjen e parë zgjedhin Kryetarin.

Anëtarët e Këshillit mbikqyrës nuk mund të jenë të punësuar në Bankë, neto debitorë të Bankës dhe persona të tjerë të parashikuar me Ligj.

Anëtarët e Këshillit mbikqyrës posedojnë këto kualifikime:

- minimum arsimim të lartë;
- njohje të akteve nga fusha e bankave dhe/ose financave dhe njohjen e industrisë financiare dhe rrethinën ku vepron Banka;
- njohje të rregullave për qeverisje të mirë korporative;
- përvojë e cila kontribon për udhëheqjen dhe qëndrueshmërinë stabile, të sigurt dhe efikase të veprimtarisë së bankës

Anëtari i Këshillit mbikqyrës duhet:

- të posedojë ndershmëri, kompetencë, aftësi për vlerësim të pavarur dhe integritet personal të fortë;
- t'a njohë profilin e rrezikshmërisë së Bankës;
- t'a kuptojë rolin e tij në udhëheqjen korporative dhe me efikasitet t'a përmbush rolin e tij të mbikqyrjes në Bankë;
- t'a njohë rrethinën ligjore dhe të kujdeset për vendosjen dhe mirëmbajtjen e raporteve profesionale me BPRM-në dhe me institucionet tjera kompetente të supervizionit dhe rregullimit;
- të shpreh besnikëri dhe kujdes për Bankën;
- të mënjanë konflikt interesi ose konflikt të mundshëm interesi;
- së paku njëherë në vit të kryej vlerësim për punën e Këshillit drejtues të Bankës, me çrast bazë fillestare të paraqesin politikat dhe planet afariste për punën e Bankës;
- periodikisht të kryej vlerësim mbi punën personale, t'i identifikojë dobësitë në punën e Këshillit mbikqyrës dhe të propozojë ndryshime;
- të mbajë takime të rregullta me Këshillin drejtues, Këshillin për menaxhimin me rreziqet, Këshillin për revizion dhe Shërbimin për revizion të brendshëm të Bankës;
- të japë propozime për udhëheqje të mirë korporative;
- të mos marrë pjesë në udhëheqjen e përditshme me bankën.

Përveç kriterëve të përmendura, anëtarët e pavarur të Këshillit mbikqyrës dhe personat fizik të lidhur me to duhet ti plotësojnë këto kriterë:

- të mos jenë aksionarë me pjesëmarrje të kualifikuar dhe të mos përfaqësojnë aksionarë me pjesëmarrje kualifikuese në Bankë;
- të mos punojnë, respektivisht në tre vitet e fundit të mos kenë punuar në Shoqatën për revizion e cila në atë periudhë ka kryer revizion mbi punën e Bankës dhe
- në tre vitet e fundit të mos kenë pasur interesa material ose raport afarist me bankën në vlerë që mesatarisht në vit tejkalon shumën prej 3.000.000 denarë.

Anëtarët e Këshillit mbikqyrës duhet të kenë njohuri dhe përvojë adekuate për realizimin e kompetencave të tyre, të shmangin konfliktin e interesit dhe ti përkushtojnë kohë të mjaftueshme detyrimeve që dalin nga kompetencat e parashikuara me këtë ligj dhe njëashtu bashkarisht duhet të kenë njohuri dhe përvojë të nevojshme për mbikqyrje të pavarur të punës së bankës, në veçanti për të kuptuarit e aktiviteteve që i kryen banka dhe për rreziqet materiale në të cilët është e ekspozuar.

Anëtar i Këshillit mbikqyrës të bankës nuk mund në një kohë të jetë edhe:

- anëtar i një organi drejtues dhe i një organi për mbikqyrje, respektivisht të kryejë funksionin e anëtarit ekzekutiv dhe atij jo-ekzekutiv të këshillit të drejtorëve në institucione financiare jobankare ose institucione jofinanciare ose
- anëtar i tre organeve të mbikqyrjes, respektivisht të kryejë tre funksione të anëtarit jo-ekzekutiv të drejtorëve në institucione financiare jobankare ose institucione jofinanciare.

Kufizimet e parashikuara me Kodin për qeverisje korporative dhe Ligjin për banka për anëtarët e këshillit mbikqyrës, nuk kanë të bëjnë me anëtarësinë në organe të organizatave joprofitabile në bazë vullnetare, pa kompenzim dhe në organe të shoqatave tregtare që i përkasin grupacionit të njëjtë bankar në Republikën e Maqedonisë ose jashtë vendit.

Në rastet kur Banka, si pjesë e grupacionit bankar, zbaton politika të grupacionit, anëtarët e këshillit mbikqyrës dhe/ose këshillit drejtues duhet të sigurojnë që ato politika të jenë adekuate për bankën dhe të jenë në përputhje me ligjet e Republikës së Maqedonisë dhe standardet e Bankës Popullore.

Mandati i ndonjërit prej anëtarëve të Këshillit mbikqyrës mund të ndërpritet edhe para skadimit në rastet kur janë plotësuar kushtet të cilat pamundësojnë emërimin e anëtarit, nëse Guvernatori i BPRM-së e tërheq pëlqimin për emërimin e anëtarit, nëse anëtari është neto debitor i Bankës, me kërkesë personale dhe në raste të tjera të përcaktuara me Ligj.

Person i njëjtë nuk mund të jetë anëtar i pavarur i këshillit mbikqyrës në bankë të njëjtë më shumë se tre mandate të njëpasnjëshme.

Në rast të ndërprerjes së parakohshme të funksionit të anëtarit të Këshillit mbikqyrës, në mbledhjen e parë të rradhës së Kuvendit të Bankës do të zgjedhet anëtar i ri i Këshillit mbikqyrës.

Kompenzimi për anëtarët e Këshillit mbikqyrës do të përcaktohet nga ana e Kuvendit të Bankës dhe/ose në Statutin e Bankës, kurse të dhënat mbi lartësinë e të ardhurave të anëtarëve të Këshillit mbikqyrës janë të përfshirë në Raportin vjetor për punën e bankës.

6. KRITERET DHE RREGULLAT PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE NË KËSHILLIN DREJTUES DHE SHPËRBLIMI I TYRE, PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE NË KËSHILLIN PËR REVIZION, ANËTARËVE NË KËSHILLIN PËR MENAXHIM ME RREZIQE DHE NË ORGANET E TJERA TË BANKËS

6.1 Kriteret dhe rregullat për emërimin e anëtarëve të Këshillit drejtues

Këshilli drejtues i Bankës përbëhet prej 4 (katër) anëtarëve, të cilët njësoj janë përgjegjës për punën e Bankës dhe për obligimet që i merr Banka.

Këshilli mbikqyrës i Bankës me Vendim i emëron anëtarët e Këshillit drejtues, pas marrjes përkatëse të pëlqimit për emërimin e tyre nga Guvernatori i Bankës Popullore të RM-së. Me Vendimin e Këshillit mbikqyrës për emërimin e anëtarëve të Këshillit drejtues përcaktohet cili nga anëtarët e Këshillit drejtues do të jetë Kryetar i Këshillit drejtues dhe ai emërohet në funksionin “Drejtor egzekutiv kryesor i Bankës”. Anëtarët e tjerë të Këshillit drejtues emërohen me funksionin “Drejtor egzekutiv” i Bankës.

Këshilli mbikqyrës i Bankës, në pajtim me aktet ligjore nënshkruan kontrata menaxheriale me anëtarët e Këshillit drejtues.

Veprimtaria e anëtarit të Këshillit drejtues është lëndë e vlerësimit nga ana e Këshillit mbikqyrës së paku njëherë në vit dhe varësisht nga vlerësimi vendoset mbi angazhimin e tij të mëtutjeshëm, rregulluar me kontratën e lartpërmendur.

Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues mund të ndërpritet edhe para skadimit në rast se Guvernatori i BPRM-së e tërheq pëlqimin për emërimin e anëtarit, me kërkesë personale, në bazë të vendimit të organit kompetent – Këshilli mbikqyrës dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligj.

Nëse numri i anëtarëve të Këshillit drejtues zvogëlohet nën 2 (dy), Këshilli mbikqyrës nga anëtarët e tij emëron ushtrues ose ushtrues në detyrë “anëtar i Këshillit drejtues”.

‘Ushtrues/ë në detyrë’ anëtar i Këshillit drejtues” janë lëndë e regjistrimit në Regjistrin Tregtar. Anëtari i Këshillit mbikqyrës, i cili është emëruar ushtrues në detyrë “anëtar i Këshillit drejtues”, gjatë periudhës së ushtrimit të kësaj detyre, nuk mund të merr pjesë në marrjen e vendimeve që janë nën kompetencën e Këshillit mbikqyrës.

Anëtarët e Këshillit drejtues emërohen më mandat prej 2 (dy) vite me mundësi për riemërim.

Për anëtar të Këshillit drejtues të Bankës mund të emërohet person që i përmbush me Ligj kushtet e parashikuara.

Këshilli mbikqyrës gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit drejtues duhet të kujdeset së paku për këto kritere:

- arsimim të lart përkatës;
- së paku 6 vite përvojë pune me sukses në fushën e financave ose bankingut ose 3 vite përvojë pune si person me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme në Bankë, me aktivitete përkatëse për Bankën ku emërohet ;
- të njohë profilin e rrezikshmërisë së Bankës;
- njohje të akteve nga fusha e financave dhe/ose bankingut
- të posedojë ndershmëri, imazh, profesionalizëm, aftësi për punë organizative, pavarësi në vlerësim dhe në vendimmarrje, integritet të fortë personal;
- të shpreh vullnet dhe aftësi që ti përmbahet standardeve të larta të sjelljes etike;
- funksionin e tij ta kryejë në mënyrë të ndershme, të pavarur, të paanshme, me diskrecion;
- të posedojë kualitete për besnikëri ndaj Bankës;
- të kujdeset për imazhin dhe punën me sukses të Bankës dhe të mënjanojë konfliktet e interesit ose konfliktet e mundshme të interesit;
- të posedojë njohuri profesionale dhe përvojë për menaxhim të pavarur të bankës, në veçanti të kuptuarit e aktiviteteve që i kryen banka dhe rreziqet materiale në të cilat është e ekspozuar, në përputhje me rregullat për qeverisje të mirë korporative sipas dispozitave të Ligjit mbi Bankat dhe me rregullat për qeverisje të mirë korporative të parashikuara nga ana e Këshillit të Bankës populllore të miratuara në përputhje me standardet ndërkombëtare

Anëtarët e Këshillit drejtues janë në marrëdhënie të rregullt të punës në Bankë dhe së paku njëri prej anëtarëve duhet t’ a njohë gjuhën maqedone dhe shkrimin qirilik dhe të ketë vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë.

Anëtar i Këshillit drejtues të Bankës, përveç personit në pajtim me rregullativën nuk i përmbush kushtet për person me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme, nuk mund të jetë edhe personi që është anëtar i organit të udhëheqjes ose të këshillit mbikqyrës të cilës do shoqëri tregtare.

Anëtarët e Këshillit drejtues janë në marrëdhënie të rregullt të punës në Bankë, dhe së paku një prej anëtarëve duhet ta njohë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj qirilik dhe të ketë vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë.

Anëtar i Këshillit drejtues të Bankës, përveç personit që në pajtim me rregullativën nuk i plotëson kushtet kushtet për person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, nuk mund të jetë edhe personi i cili është anëtar i organit të qeverisjes së cilës do shoqate tregtare.

Anëtar i këshillit drejtues të bankës nuk mund në një kohë të jetë edhe anëtar i më së shumti dy organeve të mbikqyrjes, respektivisht anëtar jo-ekzekutiv i këshillit të drejtorëve në më së shumti dy institucione financiare jobankare ose institucione jofinanciare.

Kufizimet e parashikuara me Kodin për qeverisje korporative dhe Ligjin mbi bankat për anëtarët e këshillit mbikqyrës, nuk kanë të bëjnë me anëtarësinë në organe të organizatave joprofitabile në bazë

vullnetare, pa kompenzim dhe në organe të shoqatave tregtare që i përkasin grupacionit të njëjtë bankar në Republikën e Maqedonisë ose jashtë vendit.

Këshilli mbikqyrës është i obliguar të kryejë mbikqyrje mbi punën e anëtarëve të Këshillit drejtues dhe ta ndjekë punën e personave kompetentë për funksionet e kontrollit. Në rastet kur këta persona nuk i përmbahen kulturës dhe vlerave korporative, nivelit dhe kulturës së pranueshme të rrezikshmërisë, këshilli mbikqyrës është i obliguar të merr masa përkatëse, përfshirë edhe shkarkimin e tyre, ose kërkesën për shkarkimin e tyre, në rast se Këshilli drejtues është kompetent për emërimin/shkarkimin e tyre.

Këshilli mbikqyrës sjell politika për shpërblim të anëtarëve të Këshillit drejtues, personave tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme që ushtrojnë funksione udhëheqëse dhe të punësuarëve në Bankë. Në politikat për shpërblim, Këshilli mbikqyrës i definon rregullat dhe kriteret për përcaktimin e shumës variable të kompenzimit, bonuset vjetore dhe të ardhurat tjera në jopara, me çrast i ka parasysh këto kritere:

- opusin e kompetencave të çdo anëtari të Këshillit drejtues;
- suksesin në ushtrimin e funksionit – anëtar i Këshillit drejtues;
- zbatimin e strategjisë dhe planit vjetor të punës së Bankës;
- ndërlíkueshmëria në udhëheqjen me Bankën, duke marrë parasysh opusin dhe ndërlíkueshmërinë e aktiviteteve dhe strukturën e tij organizacionale;
- opusi i punës së Bankës dhe gjendja financiare e Bankës;
- kushtet ekonomike në të cilën vepron Banka.

Politika e shpërblimit patjetër miratohet nga ana e Kuvendit të Bankës, nëse Kuvendi parashikon marrjen e kompenzimit në formë akcioni ose të drejta të tjera që mundësojnë përvetësimin e aksioneve.

Vendimi për shpërblim sillet nga ana e Këshillit për shpërblim të Bankës.

Raporti vjetor për punën e Bankës përmban edhe të dhëna për politikën e shpërblimit të Këshillit drejtues të Bankës që kanë të bëjnë së paku me këto elemente:

- kriteret themelore për shpërblim;
- ekzistimi i kompenzimit variabil dhe fiks, përfshirë edhe aprovimin e bonuseve vjetore;
- shuma e të ardhurave të anëtarëve të Këshillit mbikqyrës dhe Këshillit drejtues dhe personave të tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta që ushtrojnë funksion udhëheqës në Bankë;
- shuma e kredive të lejuara dhe format e tjera të ekspozimit dhe detyrime të tjera ndaj këtyre personave

- **Vlerësimi i përshtatshmërisë së anëtarëve të Këshillit mbikqyrës dhe Këshillit drejtues**

Këshilli mbikqyrës kryen vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatit për anëtar, respektivisht anëtarit të Këshillit mbikqyrës, i cili përbëhet nga **vlerësimi individual** i përshtatshmërisë së kandidatit për anëtar, respektivisht anëtarit të Këshillit mbikqyrës dhe **vlerësimi kolektiv** i përshtatshmërisë së anëtarit të Këshillit mbikqyrës bashkë me anëtarët e tjerë të këshillit.

Vlerësimi individual dhe kolektiv kryhet para çdo emërimi të anëtarit të ri të Këshillit mbikqyrës, riemërimi të anëtarit ekzistues edhe atë një herë në vit.

Me përjashtim, vlerësimi individual dhe kolektiv gjatë emërimit të anëtarit të ri ose riemërimit të anëtarit ekzistues të Këshillit mbikqyrës, mund të kryhet edhe pas emërimit ose riemërimit të anëtarit nga ana e Kuvendit të Bankës, por më së voni në afat prej një muaji nga emërimi i tij dhe para pranimit të pëlqimit nga Guvernatori i Bankës Popullore.

Vlerësimi individual i Këshillit mbikqyrës përfshin vlerësimin e asaj nëse:

- njohuria dhe përvoja e kandidatit për anëtar, respektivisht anëtarit të Këshillit mbikqyrës janë adekuate për realizimin e kompetencave, çka nënkupton të paktën vlerësimin e kuptimit të tij për qeverisjen e vendosur korporative të Bankës dhe për rolin e këshillit mbikqyrës në qeverisjen korporative, vlerësimin e trajnimeve, vlerësimin e përvojës profesionale dhe vlerësimin e gjendjes financiare dhe profilit të rrezikshmërisë së bankës;
- ekzistimi i konfliktit të interesit e kufizon aftësinë e kandidatit për anëtar, respektivisht anëtarit të këshillit mbikqyrës objektivisht dhe në mënyrë të pavarur ti kryejë kompetencat dhe aftësitë të kryejë vlerësim të pavarur dhe objektiv të zgjedhjeve që propozohen nga anëtarët e tjerë të këshillit mbikqyrës, në mënyrë të pavarur ti analizojë vendimet e këshillit drejtues dhe të shmang ndjekjen e qëndrimeve kolektive;
- kandidat për anëtar, respektivisht anëtar i Këshillit mbikqyrës posedon reputacion, çka, ndër të tjera nënkupton respektimin e dispozitave ligjore dhe detyrimeve kontraktuese, bashkëpunim me organet e supervizionit dhe organet e tjera kompetente dhe respektimin e kulturës dhe vlerave korporative të Bankës;
- kandidati për anëtar, respektivisht anëtari i Këshillit mbikqyrës, do mund të shpenzojë kohë të në realizimin e detyrimeve që dalin nga kompetencat e tij, duke i pasur parasysh anëtarësitë e tij në organet e mbikqyrjes dhe/ose drejtimit të subjekteve të tjera juridike ose organizatave joprotabile dhe numrit të zakonshëm të mbledhjeve që duhet të merr pjesë si rezultat i atyre anëtarësive, natyrën e çdo anëtarësie dhe kompetencave që ka kandidati për anëtar, respektivisht anëtari i këshillit mbikqyrës të bankës, kohën e nevojshme për trajnim adekuat të anëtarit të këshillit mbikqyrës për realizimin e të gjitha funksioneve të tij dhe të ngjashme.

Vlerësimi kolektiv ka të bëjë të paktën me vlerësimin nëse anëtarët bashkarisht kanë njohuri dhe përvojë të nevojshme për mbikqyrje të pavarur të punës së bankës, në veçanti për të kuptuarit e aktiviteteve që i kryen banka dhe rreziqeve materiale në të cilat është e ekspozuar banka.

Vlerësimi kolektiv duhet të përmbajë të paktën nëse anëtarët e këshillit mbikqyrës:

- kanë përvojë nga fusha të ndryshme që mundësojnë që këshilli mbikqyrës të mund të vlerësojë dhe ndjek punën e këshillit mbikqyrës dhe vendimet që i sjell. Njohuritë e ndryshme dhe përvoja mund ti referohen: menaxhimit me rreziqet, kryerjen e analizave financiare, njoftimit financiar dhe të kontabilitetit, teknologji informatike, tregjeve të kapitalit, planifikimit strategjik, revizionit të brendshëm, përputhshmërisë me aktet, shpërblimin e suksesit në punë e të tjera;
- kanë njohuri adekuate për ekonominë dhe financat lokale, rajonale, dhe nëse është nevoja edhe për atë globale, si dhe njohuri të rregullativës adekuate vendore dhe standardeve ndërkombëtare;
- posedojnë aftësi për këmbim të përvojave dhe njohurive dhe bashkëpunim reciprok.

Plus, vlerësimi vjetor përfshin edhe:

- vlerësimin e punës personale që nduhet ta kryejë në nivel vjetor secili anëtar i këshillit mbikqyrës;
- vlerësimin e madhësisë dhe përbërjes së këshillit mbikqyrës, si dhe madhësisë dhe përbërjes së këshillave të parashikuara me ligj dhe bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë;
- vlerësimin e efikasitetit të mbikqyrjes që e kryen këshilli mbikqyrës si pjesë e qeverisjes korporative të bankës dhe identifikimin e aktiviteteve ku ka nevojë për avancim ose ndryshime;
- vlerësimin e efikasitetit të këshillave të parashikuara me ligj.

Këshilli mbikqyrës është i obliguar që ta njoftojë Kuvendin e Bankës për rezultatet e vlerësimit të kryer të këtij vendimi, bashkë me aktivitetet që i propozon ose që i ka marrë për tejkalimin e mangësive të përcaktuara.

Vlerësimi kolektiv i anëtarëve të Këshillit mbikqyrës dhe Këshillit drejtues realizohet edhe nëse ka ndryshime të qenësishme në modelin afarist të bankës.

Vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatit për anëtar, respektivisht anëtar të Këshillit drejtues e bën Këshilli mbikqyrës i Bankës dhe zbatohen vlerësimet e lartpërmendura, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e Këshillit drejtues.

6.2 Kriteret dhe rregullat për emërimin e anëtarëve të Këshillit për menaxhimin me rreziqet

Këshilli për menaxhimin me rreziqet përbëhet nga shtatë (7) anëtarë. Anëtarët i emëron Këshilli mbikqyrës i Bankës. Këshilli mbikqyrës i Bankës nga rradha e anëtarëve të Këshillit për menaxhimin me rreziqet emëron kryetar të Këshillit. Dy (2) nga anëtarët e Këshillit drejtues janë anëtarë të Këshillit për menaxhimin me rreziqet.

Anëtarët e Këshillit për menaxhimin me rreziqet zgjidhen nga rradha e personave me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme të punësuar në Bankë, të cilët detyrimisht kanë përvojë nga fusha e financave apo bankingut prej së paku 3 (tre) vite. Me vendimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit për menaxhimin me rreziqet emërohen edhe zëvendës anëtarët nga rradha e personave me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme, të cilët i zëvendësojnë anëtarët në mungesë të tyre. Anëtarët e Këshillit për menaxhimin me rreziqet zgjidhen nga rradha e personave me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme, të punësuar në Bankë.

Gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit për menaxhimin me rreziqet, Këshilli mbikqyrës duhet të kujdeset së paku për këto kritere:

- të ketë përvojë pune në fushën e bankingut ose financave së paku 3 (tre) vite
- të ketë arsimim të lartë përkatës
- njohje të akteve nga fusha e bankingut dhe/ose financave
- aftësi për vlerësim të pavarur, ndershmëri dhe integritet të fortë personal
- gadishmëri që të vendosen interest e Bankës mbi interest personale dhe të mënjanohet konflikti i interesit.

6.3. Kriteret dhe rregullat për emërimin e anëtarëve të Këshillit për revizion

Këshilli për revizion përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, të cilët i emëron Kuvendi i Bankës me mandat prej 4 (katër) viteve. Shumica e anëtarëve për revizion (tre) zgjidhen nga rradha e anëtarëve të Këshillit mbikqyrës, kurse të tjerët janë anëtarë të pavarur. Së paku njëri prej anëtarëve të Këshillit për revizion duhet të jetë revizor i autorizuar nga Instituti i revizorëve të autorizuar i Republikës së Maqedonisë.

Gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit për revizion, Kuvendi i Bankës duhet të kujdeset për së paku këto kritere:

- t'i plotësojë kushtet për personat me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme;
- të ketë njohuri mbi veprimtarinë e Bankës, produktet dhe shërbimet e saj

- njohuri mbi rreziqet në të cilat është e ekspozuar Banka
- njohuri mbi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe politikat për menaxhimin me rreziqet e Bankës
- të ketë njohuri mbi kontabilitetin dhe revizionin.

Anëtarë të Këshillit mbikqyrës, Këshillit drejtues, Këshillit për menaxhimin me rreziqet dhe Këshillit për revizion, si dhe persona të tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme nuk mund të jenë këta persona:

- anëtar i Këshillit të Bankës Popullore;
- të punësuar në Bankën Popullore;
- i cili për veprat penale kundër pronës, veprave penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë, veprat penale kundër ushtrimit të detyrës si dhe veprat penale për falsifikim të dokumenteve zyrtare, rasteve të veçanta të falsifikimit të dokumenteve zyrtare, falsifikim kompjuterik, përdorim të dokumentit me përmbajtje të pavërtetë nga Kodi penal që është gjykuar me vendim të plotëfuqishëm me dënim pa kusht – burg mbi gjashtë muaj, derisa zgjasin pasojat juridike të dënimit
- person të cilit i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje, respektivisht dënim për ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- person cili nuk posedon reputacion me çrast do mundej të rrezikohet puna e sigurt dhe stabile e Bankës;
- persona të cilët nuk i respektojnë dispozitat e Ligjit mbi bankat dhe aktet tjera nënligjore dhe/ose kanë vepruar ose vepronë në kundërshtim me masat e shqiptuara nga guvernatori, me çrast janë ose rrezikohet siguria dhe stabiliteti i Bankës.
- anëtar i Këshillit mbikqyrës, Këshillit për menaxhimin me rreziqet, Këshillit për revizion, Këshillit drejtues ose i punësuar në Bankë tjetër; dhe
- person i cili më parë ka ushtruar funksion si person me të drejta dhe përgjegjësi të veçantë në bankë ose në person tjetër juridik, në të cilën është vendosur administrata ose mbi të cilën është inicuar procedurë e hapur për falimentim apo likuidim, përveç nëse padyshim, mbi bazën e dokumenteve dhe të dhënave të disponueshme vërtetohet se personi nuk ka kontribuar në paraqitjen ekushteve për iniciimin e administrimit, procedurës së falimentimit apo likuidimit ose funksionin e ka ushtruar para ose pas paraqitjes së shkaqeve që kanë sjellur deri te administrimi, hapja e falimentimit ose zbatimi i procedurës së likuidimit.

6.4 Kriteret dhe rregullat për emërimin e anëtarëve të Këshillit kreditues

Këshilli kreditues i Bankës përbëhet nga Kryetari dhe 2 (dy) anëtarë dhe numër të njëjtë të zëvendësve, të cilët i emëron dhe shkarkon Këshilli mbikqyrës i Bankës. Anëtarë të Këshillit kreditues janë: Kryetari i Këshillit drejtues/Drejtori kryesor egzekutiv dhe dy anëtarë të Këshillit drejtues/Drejtorë egzekutiv.

Me vendimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit kreditues emërohen edhe zëvendës të anëtarëve të Këshillit kreditues nga rrada e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të cilët i zëvendësojnë anëtarët në mungesë të tyre. Mandati i anëtarëve të Këshillit kreditues është 4 (katër) vite.

Gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit kreditues, Këshilli mbikqyrës duhet të kujdeset për së paku këto kritere:

- të ketë përvojë përkatëse nga fusha e punëve bankare ose financave
- të ketë arsimim të lartë përkatës
- njohuri mbi aktet nga fusha e bankave dhe/ose financave

- aftësi për vlerësim të pavarur, ndershmëri dhe integritet të fortë personal
- gadishmëri që të vihen interesat e Bankës mbi interesat personale dhe të shmangët konflikti i interesit.

7. ROLI, KUPTIMI DHE FUSHËVEPRIMI I I PUNËS SË FUNKSIONEVE TË KONTROLLIT

Funksione të kontrollit në Bankë janë revizioni brendshëm, menaxhimi me rreziqe dhe kontroll të përputhshmërisë me aktet, respektivisht Drejtoria për revizion të brendshëm, Drejtoria për menaxhim me rreziqe dhe Drejtoria për përputhshmëri të akteve, SPP dhe FT.

Këshilli mbikqyrës dhe Këshilli drejtues i Bankës janë të obliguar t'ju sigurojnë pavarësi të plotë Drejtorive me funksion kontrolli, përmes vendosjes së konfigurimit adekuat organizacional përmes ndarjes së tyre reciproke dhe ndarje nga aktivitetet që janë lëndë e kontrollit të tyre, sigurimin e qasjes të pandërprerë deri te të gjithë të punësuarit në bankë dhe deri te të gjitha informacionet e nevojshme për zbatimin e funksionit të kontrollit, vendosjen e mekanizmit për bashkëpunim të pandërprerë midis personave të përfshirë në realizimin e funksioneve të ndara të kontrollit dhe të punësuarëve të tjerë në bankë dhe mënyrën e shpërblimit të personave të përfshirë në realizimin e funksioneve të ndara të kontrollit që nuk është i lidhur me suksesin e aktiviteteve që janë lëndë e kontrollit të tyre.

Gjatë emërimit të personave udhëheqës të Drejtorive me funksion kontrolli, Këshilli mbikqyrës dhe Këshilli drejtues duhet që të emërojnë persona që nuk janë të nënshtuar në subordinim me personat përgjegjës për aktivitetet që janë lëndë e kontrollit të tyre.

Drejtoritë me funksion kontrolli duhet të jenë të përfaqësuar me resurse adekuate njerëzore dhe materiale për realizimin e pavarur, objektiv dhe efikas të funksioneve të kontrollit, kurse vendosja e kontrollit të jetë në atë mënyrë që të mundësojë shmangien e konflikteve të interesit.

Drejtorët e Drejtorive me funksion kontrolli duhet të kenë qasje të pakufizuar te anëtarët e Këshillit mbikqyrës të Bankës dhe të mundën ti njoftojnë për mangësi qenësore, mangësi ose rreziqe që i kanë identifikuar gjatë kryerjes së funksionit të tyre.

Në rast se ndodh shkarkimi i Drejtorit të Drejtorisë për menaxhim me rreziqet dhe Drejtorit të Drejtorisë për përputhshmëri të akteve dhe SPP dhe FT, duhet të njoftohet Këshilli mbikqyrës nga ana e Këshillit drejtues për shkarkimet dhe arsyet, kurse në afat prej 15 ditëve nga dita e shkarkimit njoftohet edhe Banka Popullore e RM-së.

7.1 Revizioni i brendshëm

Këshilli mbikqyrës i Bankës organizon Drejtorin për revizion të brendshëm, si pjesë e pavarur organizacionale e Bankës i cili i emëron dhe shkarkon anëtarët e saj.

Pozicionimi organizacional, të drejtat, përgjegjësitë dhe raportet me pjesët tjera organizacionale të Bankës, si dhe përgjegjësia dhe kushtet për emërimin e Udhëheqësit të Shërbimit për revizion të brendshëm i përcakton Këshilli mbikqyrës.

Personat në Shërbimin për revizion të brendshëm janë të punësuar në Bankë dhe kryejnë punë vetëm në Shërbimin për revizion të brendshëm. Shërbimi për revizion të brendshëm përbëhet nga Udhëheqësi i

shërbimit dhe nga numër i nevojshëm i anëtarëve për punën e shërbimit, nga të cilët së paku (1) një posedon autorizim për revizor dhënë nga Instituti i revizorëve të autorizuar i Republikës së Maqedonisë.

Drejtoria për revizion të brendshëm i zbaton aktivitetet e tij në pajtim me principet dhe standardet e revizionit të brendshëm, kodit etik të Bankës dhe politikave dhe procedurave të punës në Shërbim.

Drejtoria për revizion të brendshëm përgatit Plan vjetor të punës, të cilin e aprovon Këshilli mbikqyrës. Drejtoria përgatit raporte gjysëmvetore dhe vjetore për punën e tij, të cilët i dorëzon deri te Këshilli mbikqyrës, Këshilli drejtues dhe Këshilli për revizion. Këshilli mbikqyrës Raportin vjetor të Shërbimit për revizion të brendshëm e dorëzon deri te Kuvendi i Bankës dhe deri te BPRM-së.

Drejtoria për revizion të brendshëm kryen revizion të vazhdueshëm dhe të plotë të ligjshmërisë, rregullueshmërisë dhe azhurnimit të punës së Bankës nëpërmjet:

- Vlerësimin të vendosjes së sistemit informatik;
- Kontrollit të saktësisë, besueshmërisë dhe kohës së njoftimeve, në pajtim me aktet;
- Vlerësimin të ekonomitetit dhe efikasitetit të operacioneve në Bankë;
- Zbatimit të hulumtimeve speciale në bankë;
- Vlerësimin të adekuatitetit dhe efikasitetit të sistemit për kontroll të brendshëm;
- Vlerësimin të zbatimit të politikave për menaxhimin me rreziqet;
- Vlerësimin të saktësisë dhe besueshmërisë së librave tregtarë dhe raporteve financiare;
- Vlerësimin të sistemeve për parandalimin e larjes së parave;
- Përcjelljes së respektimit të akteve, Kodit etik, politikave dhe procedurave të bankës;
- Vlerësimin të shërbimeve që Banka I merr nga shoqatat që kryejnë shërbime ndihmëse në Bankë dhe
- kryerjen e aktiviteteve tjera në pajtim me rregullativën ligjore, nënligjore dhe aktet interne të Bankës, dhe për këtë dorëzon deri te organet udhëheqëse të Bankës raporte dhe rekomandime.

Personat e punësuar në Drejtorinë për revizion të brendshëm kanë të drejtë në qasje të papenguar deri te të gjithë të dhënat dhe dokumentet e bankës, kurse të punësuarit e bankës janë të obliguar t'ju mundësojnë kontroll në dokumentacionin që posedojnë dhe t'ju japin të gjithë informacionet e nevojshme. Këshilli mbikqyrës, Këshilli drejtues dhe personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta që kryejnë funksion udhëheqës në Bankë kontribuojnë në rritjen e efikasitetit të revizionit të brendshëm nëpërmjet sigurimit të pavarësisë së plotë, objektivitetit dhe paanshmërisë në zbatimin e revizionit të brendshëm, sigurimin e kushteve për qasje deri te të gjithë dokumentet dhe informacionet, pranim në kohë dhe efikas të konkluzioneve dhe zbatim të rekomandimeve, promovimin e pavarësisë së revizionit të brendshëm dhe angazhimin e revizionit të brendshëm për vlerësimin e efektivitetit të sistemeve për kontroll të brendshëm dhe menaxhimin me rreziqet.

Këshilli drejtues siguron kushte në bazë të cilave Shërbimi për revizion të brendshëm të jetë e informuar tërësisht dhe në kohë për ngjarjet më me rëndësi në Bankë, për futjen e produkteve të reja dhe për ndryshime të tjera operative.

Drejtoria për revizion të brendshëm është e obliguar që menjëherë të informojë Këshillin mbikqyrës dhe drejtues nëse gjatë kontrollit përcakton:

- mosrespektim të standardeve për menaxhim me rreziqet me çrast ekziston mundësia e prishjes së likuiditetit ose aftësisë pagesore të Bankës dhe
- se Këshilli drejtues nuk i respekton rregullat, aktet e përgjithshme dhe procedurat interne të Bankës.

Drejtoria për revizion të brendshëm i dorëzon deri te Këshilli mbikqyrës dhe Këshilli për revizion raportet pa i përmbajtur korrigjimet e Këshillit drejtues ose të punësuarve të tjerë në Bankë, e të cilat nuk janë pranuar nga Drejtoria për revizion të brendshëm.

Revizioni i jashtëm (Shoqata për revizion)

Revizioni i jashtëm i raporteve financiare dhe punës së Bankës nga ana e shoqatës për revizion zbatohet në pajtim me Standardet ndërkombëtare të revizionit, Kodit etik të kontabilistëve profesional, të definuara nga ana e Federatës ndërkombëtare të kontabilistëve dhe me akte të tjera me të cilat rregullohet kryerja e revizionit të jashtëm.

Gjatë zgjedhjes së shoqatës për revizion të jashtëm, Këshilli mbikqyrës dhe Këshilli për revizion sigurojnë rrotacion periodik të shoqatës për revizion.

Këshilli për revizion propozon shoqatë për revizion, Këshilli mbikqyrës e aprovon propozimin e Këshillit për revizion për emërimin e shoqatës për revizion dhe është përgjegjës për sigurimin e revizionit përkatës, kurse Kuvendi i Bankës e zgjedh shoqatën për revizion. Pavarësia e Shoqatës së zgjedhur për revizion është esenciale për zbatimin e revizionit të thellë dhe të paanshëm, me çrast nuk është e lejuar egzistimi i animit dhe joobjektivitetit. Qëllimi i revizionit të jashtëm është vlerësimi i pavarur i gjendjes së tërësishme të Bankës në një moment të caktuar.

Këshilli për revizion propozon, kurse Kuvendi i Bankës vendos mbi prishjen e kontratës së nënshkruar me shoqatën e revizionit.

Me revizionin, Shoqata për revizion në veçanti e vlerëson bilancin e gjendjes, bilancin e suksesit, raportin mbi rrjedhën e parasë, ndryshimet në lartësinë e mjeteve vetjake dhe vlerësimin e adekuatitetit të kapitalit, nivelin dhe ndryshimin e lartësisë së vlerës së korrigjuar dhe rezervës së mbledhur të veçantë dhe për çregjistrimet e realizuara, shumën e detyrimeve potenciale të ndërmarra, funksionimin e sistemeve për kontroll të brendshëm dhe ushtrimin e funksionit të revizionit të brendshëm, udhëheqjen me librat tregtarë, adekuatiteti i politikave dhe procedurave të kontabilitetit të Bankës, vlerësimin e mjeteve dhe detyrimeve të bilansit dhe jashtë bilansit, sistemet për menaxhim me rreziqet, siguria e sistemit informatik, saktësia dhe tërësia e raporteve që banka i dorëzon deri te BPRM-së për nevojat e supervizionit, përputhshmëria e punës së Bankës me aktet dhe sistemet e bankës për menaxhimin me rreziqet.

Të gjithë të punësuarit në Bankë, anëtarët e Këshillit drejtues dhe mbikqyrës bëjnë përpjekje maksimale për bashkëpunim me revizionin e jashtëm, në veçanti me Shërbimin për revizion të brendshëm. Komunikimi ndërkombëtar ndërmjet Shërbimit për revizion të brendshëm dhe revizionit të jashtëm mundëson këmbim të informacioneve për punët me interes të përbashkët, siç janë: këmbim mendimesh rreth teknikave të revizionit, metodat e punës, interpretimet e terminologjisë, i këmben raportet e revizionit etj.

Shoqata për revizion për revizionin e jashtëm të kryer përgadit Raport, në pajtim me aktet për revizion dhe Ligjin mbi Bankat. Kuvendi i Bankës e shqyrton dhe aprovon Raportin e shoqatës për revizion dhe mendimin me shkrim nga ana e Këshillit mbikqyrës.

Raporti për revizionin e jashtëm të kryer dhe raportet financiare vjetore bashkë me vërejtjet të raportit, Banka i bën të disponueshme për publikun dhe e publikon bilansin e gjendjes, bilansin e suksesit, raportin mbi ndryshimin e kapitalit, raportin për rrjedhat e parasë dhe raportin e revizorit me raportet vjetore financiare në Gazetën zyrtare të RM-së, në së paku një gazetë ditore dhe në veb faqen e Bankës, në afat prej 15 ditëve nga aprovimi i raportit nga ana e Kuvendit të Bankës

7.2. Drejtoria/personi për kontroll të përputhshmërisë së punës së bankës me aktet

Këshilli drejtues i bankës emëron Drejtori/person për kontroll të përputhshmërisë së punës së bankës me aktet, i cili do të jetë përgjegjës për identifikimin dhe përcjelljen e rreziqeve nga mospërputhshmëria e punës së Bankës me aktet.

Drejtoria/personi për kontroll të përputhshmërisë së punës së bankës me aktet është shërbim i pavarur i Bankës. Shërbimi/personi për kontroll të përputhshmërisë së punës së Bankës me aktet për punën dorëzon raport mujor deri te Këshilli drejtues dhe raport 6 mujor deri te Këshilli mbikqyrës.

Këshilli drejtues përgatit dhe zbaton politika të shkruara për zbatimin e vazhdueshëm dhe efikas të kontrollit të përputhshmërisë së punës së bankës me aktet dhe vendos sistem me të cilin sigurohet se politika po zbatohet në mënyrë adekuate në punën e Bankës. Këshilli mbikqyrës e aprovon politikën për zbatimin e vazhdueshëm dhe efikas të kontrollit të përputhshmërisë së punës së bankës dhe bën mbikqyrje të menaxhimit me rreziqet nga mospërputhshmëria e punës së Bankës me aktet.

Organet e udhëheqjes dhe mbikqyrjes sigurojnë pavarësi të plotë të funksionit-kontroll të përputhshmërisë së punës së Bankës me aktet nëpërmjet:

- Sigurimin e statusit formal në Bankë,
- Emërimin e Drejtorisë/personit për kontroll të përputhshmërisë së punës së Bankës me aktet
- Sigurimin e vendosjes në këtë pozicion, e cila nuk do të shkaktojë konflikt interesi
- Sigurimin e qasjes deri te të gjithë informacionet që janë të nevojshme për personin/të punësuarin në Drejtorinë për kontroll të përputhshmërisë së punës së Bankës me aktet
- vendosjen e mekanizmit për bashkëpunim të pandërprerë ndërmjet personi/të punësuarit në Drejtorinë për kontroll të përputhshmërisë së punës së Bankës me aktet dhe personat që janë përgjegjës për menaxhimin me rreziqet.

Personi/të punësuarit në Shërbimin për kontroll të përputhshmërisë së punës së Bankës me aktet janë të obliguar:

- t'i ndjekin aktet që kanë të bëjnë me punën e Bankës;
- T'i identifikojnë dhe ti përcjellin rreziqet nga mospërputhshmëria e punës së Bankës me aktet;
- ti ndjekin ankesat e klientëve të Bankës
- Të përcjell dhe të testojë përputhshmërinë e punës së Bankës me aktet dhe të informojë Këshillin drejtues për mospërputhshmëritë e gjetura dhe për masat korrigjuese të ndërmarra për tejkalimin e tyre;
- Vazhdueshëm dhe në mënyrë efikase ti këshillojë anëtarët e Këshillit drejtues në lidhje me zbatimin e akteve;
- Në kohë ti informojnë anëtarët e Këshillit drejtues për ndryshimet dhe plotësimet e akteve;

- Të kryen vlerësimin e ndikimit potencial nga ndryshimet e akteve mbi punën e Bankës dhe mbi rrethinën në të cilën funksionon Banka;
- Të informojnë, dhe si të zbatojnë trajnime për të punësuarit për mënyrat e implementimit të akteve përkatëse ligjore dhe nënligjore në punën e tyre të përditshme;
- Të bëjnë vlerësimin e përputhshmërisë së produkteve të reja të Bankës dhe proceset afariste në Bankë me kornizën ligjore dhe nënligjore;
- Të përmbushin obligime të tjera ligjore (aktivitete për parandalimin e larjes së parave);
- të japin udhëzime për zbatimin e drejtë të akteve në formën e rekomandimeve, përfshirë edhe rekomandimeve për ndryshimin e akteve përkatëse interne, si dhe dhënien e përgjigjeve të punësuarëve për pyetje lidhur me zbatimin e akteve
- Të bashkëpunojë me institucione të tjera dhe
- Të dokumentojë punën e tij dhe rregullisht të dorëzojë raporte deri te Këshilli drejtues dhe mbikqyrës i Bankës.

Të punësuarit në Bankë janë të obliguar që të punësuarve në Shërbimin/personin për kontroll të përputhshmërisë së punës së Bankës me aktet t'ju mundësojnë qasje në dokumentacionin që posedojnë dhe tu japin gjithë informacionet e nevojshme.

Aktivitetet e zbatuara nga ana e Shërbimit/personit për kontroll të përputhshmërisë së punës së Bankës me aktet janë rregullisht nën revizionin e rregullt nga ana e Shërbimit për revizion të brendshëm në pajtim me Planin vjetor për revizion të brendshëm.

7.3. Drejtoria për menaxhim me rreziqe

Drejtoria për menaxhim me rreziqe është njësi e pavarur organizacionale, nën kompetencën e drejtpërdrejt të Këshillit mbikqyrës të Bankës.

Drejtoria për menaxhim me rreziqe është kompetente për:

- identifikim, matje dhe vlerësim, kontroll ose ulje dhe monitorim të rreziqeve materiale;
- zbatim të politikave dhe akteve interne për identifikim, matje dhe vlerësim, kontroll ose ulje dhe monitorim të rreziqeve;
- monitorim të rregullt të limiteve të ekspozimeve të rreziqeve individuale;
- shqyrtim të rezultateve nga stres-testimi i kryer;
- njoftim të rregullt të Këshillit për menaxhim me rreziqe dhe organeve të tjera të bankës për ekspozimet e bankës ndaj rreziqeve të caktuara.

Këshilli drejtues është i obliguar që Drejtorisë për menaxhim me rreziqe ti mundësojë të ketë qasje deri te të gjitha njësitë organizacionale në Bankë, puna e të cilëve mund ta ekspozojë Bankën ndaj rreziqeve materiale dhe të ketë resurse të mjaftueshme për kryerjen e kompetencave të parashikuara.

8. PERSONA TË TJERË ME TË DREJTA DHE PËRGJEGJËSI TË VEÇANTA

Persona të tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, për nevojat e kësaj pike, janë personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të përcaktuara me Statutin e Bankës, me përjashtim të anëtarëve të Këshillit mbikqyrës, Këshillit drejtues, Këshillit për revizion dhe Këshillit për menaxhim me rreziqe.

Personat e tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta janë:

- Drejtorë të Sektorëve,
- Drejtorë të Drejtorive të pavarura,

- Drejtorë të drejtorive dhe
- Drejtorë të degëve

Personat e tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta emërohen dhe shkarkohen nga ana e Këshillit drejtues të Bankës me mandat prej 2 (dy) vite me mundësi për rizgjedhje që i plotësojnë me Ligj kushtet e parashikuara dhe kushtet e parashikuara me Politikën për mënyrën e zgjedhjes, ndjekjen e punës dhe shkarkimin e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta.

Personat e tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta e organizojnë, koordinojnë, udhëheqin dhe janë përgjegjës për punën në fushëveprimin e punës së tyre, përcaktuar me skemën organizacionale dhe sistematizimin dhe Kontratën e punës.

Para emërimit të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, para riemërimit të tyre dhe gjatë çdo ndryshimi të rëndësishëm në punën e Bankës ose në mënyrën e kryerjes së pozitës ose funksionit përkatës, Këshilli drejtues bën vlerësim të përshtatshmërisë së personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta.

Këshilli drejtues është i obliguar që ta ndjek punën e personave të tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, të sigurojë kushte për trajnimin e tyre të vazhdueshëm, ta ndjek mënyrën e definimit dhe delegimit të kompetencave dhe përgjegjësi të punësuarve nga ana e personave të tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe të merr aktivitete për tejkalimin e mangësive të identifikuara nga vlerësimi i përshtatshmërisë së personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta.

9. STRUKTURA E HALK BANKASI A.SH

Halkbankasi A.Sh nga Turqia, e cila është themeluar në vitin 1933 si union kreditor, aktivitetet e saj i ka filluar më 26.08.1938, është pronar i 99,16% të aksioneve të përgjithsme të Bankës dhe është nën mbikqyrjen e plotë të Bankës Popullore të RM-së. 51,11% të aksioneve të Halkbankasi A.SH. janë në pronësi të Fondit të mjeteve të Turqisë.

10. KODI ETIK, POLITIKA E SHMANGIES SË KONFLIKTIT TË INTERESIT, POLITIKA E SHPËRBLIMIT DHE RREGULLORJA PËR RAPORTIM TË BRENDSHËM TË MBROJTUR

- Kodi etik

Kodi etik përpilohet nga ana e Këshillit drejtues dhe miratohet nga ana e Këshillit mbikqyrës, me qëllim të promovimit të kulturës dhe vlerave korporative.

Kodi etik domosdoshmërisht i përmban këto elemente:

- shmangien e rasteve të konfliktit të interesit;
- shmangien e rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve të tjera joligjore dhe joetike;
- definimin e sjelljes së pranueshme dhe të papranueshme çka nënkupton ndalesë të qartë të aktiviteteve në kundërshtim me ligjin dhe aktet interne dhe nxitje të punësuarve që ti respektojnë normat etike dhe ti kryejnë detyrat e tyre me ndërgjegje, me integritet, në përputhje me njohuritë dhe përvojën e tyre dhe duke i respektuar rregullat;
- veprimin gjatë kryerjes së transaksioneve me persona të ndërlidhura me Bankën dhe

-ruajtjen e fshehtësisë bankare.

- Politika e shmangies së konfliktit të interesit

Këshilli mbikqyrës është kompetent për miratimin e Politikës për shmangien e konfliktit të interesit në Bankë. Me këtë Politikë identifikohen konfliktet e mundshme të interesit dhe masat që duhet të merren në rastet kur nuk mund të parandalohet paraqitja e konfliktit të interesit.

Këshilli mbikqyrës dhe Këshilli drejtues janë kompetentë për ndjekjen e zbatimit të Politikës. Politika e shmangies së konfliktit të interesit duhet të përmbajë të paktën këto elemente:

- obligim për të gjithë personat e tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të mos lejojnë që ekzistimi i konfliktit të interesit të ndikojë mbi kryerjen e aktiviteteve të tyre;
- rastet ku mund të paraqitet konflikt interesi dhe mënyra se si të veprohet në raste të tilla;
- procedurën që duhet ta ndjekin personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta para se të fillojnë të kryejnë funksion tjetër, që të parandalohet që funksioni i ri të sjellë deri te paraqitja e konfliktit të interesit;
- obligim për personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta që menjëherë të paraqesin çfarëdo lloj situatash ose raportesh të cilat mund të sjellin ose kanë sjellë deri te paraqitja e konfliktit të interesit;
- procedura përkatëse për kryerjen e transaksioneve me personat e ndërlidhur, të cilat do të sigurojnë që këto transaksione të mos kryhen në kundërshtim me interesat dhe mundësitë e bankës dhe
- mënyra se si do të veprohet në rastet e mospërputhjes me politikën për shmangien e konfliktit të interesit.

- Politika e shpërblimit

Politika e shpërblimit miratohet nga ana e Këshillit mbikqyrës, por nëse parashikohet mundësia e përvetësimit të aksioneve, Politika miratohet nga ana e Kuvendit të Bankës.

Politika përmban rregulla të qarta dhe transparente dhe kritere për përcaktimin e shumës së kompenzimit të përgjithshëm, në veçanti për përcaktimin dhe ndarjen e qartë të pjesës fikse dhe variabile të kompenzimit të përgjithshëm.

Politika e shpërblimit duhet ti plotësojë të paktën këto kushte të shënuara më poshtë:

- të jetë në përputhje me politikën afariste të Bankës, planin financiar dhe objektivat afatgjata të Bankës;
- të mos i nxisë të punësuarit ose anëtarët e organeve të tjera të Bankës të ndërmarrin nivel më të lartë të rrezikut nga niveli i pranueshëm i rrezikshmërisë;
- të përmbajë mekanizma për shmangien e konfliktit të interesit.

- Rregullore për raportim të brendshëm të mbrojtur dhe Rregullore për shfrytëzimin e shërbimeve nga persona të jashtëm

Çështjet nga fusha e raportimit të brendshëm të mbrojtur dhe shfrytëzimit të shërbimeve nga persona të jashtëm rregullohen me akte përkatëse ligjore dhe nënligjore dhe akte interne të Bankës.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Revidimi i Kodi bëhet të paktën një herë në vit, në pajtim me ndryshimet në rregullativën interne dhe eksterne për qeverisje korporative. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Kodi hyjnë në fuqi nga dita e aprovimit të tyre nga ana e Këshillit mbikqyrës të Bankës.

Ky Kod, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij që mund të bëhen në të ardhmen, do të publikohen në ueb faqen e Halkbank AD Skopje.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKQYRËS

